

**Shpresat
e opozitës**
A po
relativizohet
censusi?

Fq.3



**PËRFUNDON
PROCEDURA**
Ansambli
shqiptar në
kërkim të selisë

Fq.5



Gabimet
me refer-
endumin
Forum

Fq.13



Koha

www.koha.mk



700 herë me
Barcelonën

Fq.21

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3470 · e enjte, 27 shtator 2018

4°C | 21°C

15 DEN

FORUM

Një ditë pas



Nëse përcjellim disponimin e qytetarëve mund të presim se, nga ata që do të votojnë, shumica do të përkrahin referendumin i cili mban vulën euro-atlantike. Ky do të ishte edhe një vërtetim i faktit që shumica e qytetarëve për më shumë se dy dekada në vazhdimësi kanë treguar përkrahje jashtëzakonisht të lartë për anëtarësim të Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Gjithsesi, kjo përkrahje edhe duhet të shndërrohet në vota në ditën e referendimit, që njëherit është obligim qytetar edhe me i lartë sesa vota në zgjedhjet politike. Nëse në zgjedhje përcaktohem për njërin ose...

Fq.11

RAJON

Ndryshimi i kufijve nuk ka gjasa të kalojë pa dhunë

Fq.15

GLOBI

Erdogani kërkon pajtim me gjermanët

Fq.15



POTENCIALE KA, MUNGOJNË INVESTIMET

DORA E SHTETIT NUK E PREK MALIN SHARR



Janë me mijëra banorë të Malësisë së Tetovës që kanë braktisur vatrat e tyre për një jetë më të mirë në vendet evropiane, duke lënë shtëpitë e tyre të pabanuara, dhe kjo do të ishte mundësi e mirë që të njëjtat të shndërrohen në bujtina, hotele, restorante për vizitorë të huaj... Megjithatë, Qeveritë po vijnë dhe shkojnë, ndërsa askush nuk investon në Malin Sharr

Fq.7

Fushatë edhe me Çarshinë

Shkup, 26 shtator - Çarshia e Shkupit gjatë periudhës së fundit ka qenë pjesë e agjendave ditore të më shumë funksionarëve të lartë shtetëror. Në prag të referendimit, nëpër kalldrëmin e saj javëve të fundit pothuajse ka kaluar i gjithë kori diplomatik. Ndonëse kryeministri Zoran Zaev dhe kabineti i tij gati për çdo ditë kanë qëndruar në Çarshi, mirëpo vizita e cila bëri më tepër bujë ishte ajo e përfaqësues së

lartë të Bashkim Evropian, Frederika Mogerinit. Defilimi i shumë funksionarëve të lartë shtetëror të vendit tonë, por edhe të huajve nëpër rrugicat e çarshisë, tregon qartë se ky kompleks historik ka peshë të madhe kulturore. Megjithatë, realiteti në të cilën për momentin gjendet dhe zhvillohet Çarshia e Shkupit, fatqësisht i ngjanë një anarkie të plotë. Për shumicën e esnafit të Çarshisë...

Fq.5



EDITORIAL

KËTU KISHTE EUROPË PARA SE TË FORMOHET BE



Emin AZEMI

Në Shkup kishte Europë para se të formohet Bashkimi European. Finisnikët katolikë të Shkupit, në fillim të shekullit të kaluar organizuan jetë kulturore me ballo e shfaqje teatrore, që s'kishin asgjë mangut nga ato që organizoheshin në Vjenë, Paris, Romë e gjetiu. Teatri, bandat muzikore, klubet kulturore, shkollat, ishin ndër oazat e para kulturore e emancipuese në mbarë hapësirën shqiptare dhe që nga Shkupi rrezatonin një rizgjim kombëtar me primesa civilizuese europiane. Pastaj do të vijin luftërat shkatërruese ballkanike e botërore dhe do të ndërpresin dhunshëm këtë kontinuitet zhvillimi, duke imponuar pastaj një kulturë tjetër, që ishte jo vetëm zëvendësim i asaj pararendëse, por edhe zvetënim i qëllimshëm i kodit të saj civilizues. Barbaria sllave e ardhur nga sallonet e Karagjorgjeviqëve bëri një ofensivë të programuar dekulturimi të këtyre hapësirave, duke dëbuar nga qendra e Shkupit kujtesën shqiptare dhe duke zëvendësuar atë me stilin e shpifur të një farë baroku klandestin. Shkupi përjetoj transformime të mëdha, por ajo që ndodhi me zhvendosjen e kulturës shqiptare nga qendra e këtij qyteti, është shpërfytyrimi më i madh që i është bërë atij.

Gjuha, arsimiti, kënga, teatri, baleti, kostumet, mënyra e jetesës, ishte alfabeti shpirtëror i shqiptarëve, kurse katolikët shqiptarë të Shkupit i dhanë kuptim qenësish kombëtarë duke e integruar këtë alfabet në sfondin e përgjithshëm të civilizimit perëndimor, atje ku shqiptarët bënin pjesë dhe për rrjedhojë del e pakontestueshme lidhshmëria e familjeve katolike shqiptare të Shkupit me përpjekjet për zhvillimin e arsimit shqip në Shkup dhe me rizgjimin kulturor e shpirtëror të shqiptarëve. Kjo kauzë emancipuese-kulturore e këtyre familjeve shquhet përmes një galerie personazhesh mjaft të spikatur që kishin vepruar në Shkup, sikundër ishin Kolë Bojaxhiu, Dom Ndue Bytyçi, Lorenc Antoni, Dom Gaspër Gjini, Vingjenc Gjini e ndonjë tjetër.

Politika asimiluese sllave nuk kishte problem gjithaq të madh me shqiptarët muslimanë, sepse ata përmes

një marrëveshjeje famëkeqe arriti t'i deportojë në shkretëtirat e Anadollit. Kjo politikë problem më të madh kishte me katolikët shqiptarë të Shkupit, sidomos me problemin që vinte nga vetëdija kombëtare që injektonte ky komunitet me aktivitete kulturore e arsimore, që ishin shumë europiane në thelb dhe aspak ortodokso-lindore. Se ky ishte vërtetë problem i madh, dëshmon edhe përpjekja aktuale për të bërë diversion mbi Kishën Katolike të Shkupit, duke emëruar në krye të saj një maqedonas katolik i rritit bizantin.

Në Maqedoni ekzistojnë dy institucione kishtarë (dioqeza) edhe atë: për katolikët e liturgjisë romake, arqipeshkvia e Shkupit dhe për katolikët e liturgjisë bizantine-sllave, Peshkopia Apostull, me seli në Strumicë. Dy institucionet kishtarë: arqipeshkvia e Shkupit dhe Peshkopia Apostull në Maqedoni prej vitit 2005 janë nën udhëheqjen e ipeshkvit të Shkupit dhe Peshkopia Apostull në Maqedoni, dr. Kiro Stojanov. Arqipeshkvia e Shkupit, nën juridiksionin e të cilëve janë besimtarët e liturgjisë perëndimore gjegjësisht romake është një prej arqipeshkive më të vjetra në Ballkan e cila fillon në vazhdimësi prej themelimit të saj.

Mirëpo ajo çka ndodhë aktualisht me Kishën katolike të Shkupit, nuk korrespondon me lavdinë shekullore që kishte ky institucion dhe më së paku me kontributin e ipeshkëve shqiptarë, të cilët përpos liturgjisë në gjuhën shqipe kishin kultivuar edhe një lëvizje emancipuese kulturore. Tani në këtë Kishë mesha nuk mbahet në gjuhën shqipe dhe ky është në alarm që duhet të zgjojë jo vetëm ipeshkvinë e Kosovës dhe autoritetet kishtarë katolike të Shqipërisë, por edhe institucionet relevante, të cilat me heshtjen e tyre sikur pajtohen me realitetet e dhunshme që mundohen të imponojnë politikat e reja të asimilimit kombëtar.

Shqiptarët ishin Europeanë kur nuk kishte as parti politike, prandaj këto të fundit e kanë për obligim t'u rikthejnë shqiptarëve Europën e grabitur nga hajnat e identiteteve kulturore.

FITORE APO SFIDË E MADHE?!

"Sot, intelektualët shqiptarë në Maqedoni, e thanë fjalën e tyre: PRO RFRNDUMIT! Dhe, pas kësaj PRO-, ta lëshuan edhe një Memorandum, se çka kërkojnë intelektualët shqiptarë pas miratimit të Referendumit. Kërkesat janë shumë të qarta: barazi të plotë të shqiptarëve me maqedonasit! As me pak e as me shume, por vetëm barazi të plotë!

Por, unë, një gjë e kam shumë të qarte: kjo do të jete sfida më e madhe me të cilën do të përballen shqiptarët. Pse? Sepse, e kaluara ka dëshmuar se dialogu shqiptaro-maqedonas, jo vetëm që ka qenë i vështirë, por edhe i pamundshëm. Ngarkesat në baza etnike dhe albanofobia të shumica e maqedonasve, dialogun dhe marrëveshjet demokratike, i bëjnë të pamundshme!

Por, cila është sfida, çka do të ndodhë dhe si do të veprohet pas Referendumit? Memorandumi i intelektualëve shqiptarë është shumë i qartë. Shqiptarët autoktonë në Maqedoni, kërkojnë shtet të përbashkët me maqedonasit, kërkojnë që në këtë shtet, të ndjehen të barabartë dhe lojalë, kërkojnë të mos jenë qiraxhinj në shtëpinë e tyre, kërkojnë të ndërtojnë shtet të përbashkët me maqedonasit, kërkojnë ardhmërinë e tyre...!

Si do të priten këto kërkesa nga pala maqedonase:?

E di: këto kërkesa do të paraqesin një 'tërmet'. Ata, me çdo kusht do ta mbrojnë statusin e shtetit unitar, duke i mbajtur afro 40% të kombit shqiptar me status pakicë. Kjo nuk ndodh askund në botën e civilizuar!

Po, si do të veprohet?

Jo. Ne, nuk do të kërkojmë luftë, jo! Ne, do të thirremi në Memorandumin tonë në Parlamentin e Maqedonisë dhe në institucionet ndërkombëtare, të cilët prej sot do ta kenë në dorë këtë platformë shumë të rëndësishme për ne.

Nëse edhe kjo platformë injorohet nga pala maqedonase, atëherë e drejta jonë është që t'i kërkojmë të gjitha format e mundshme demokratike që i kemi prezantuar. Por, pse jo, edhe Protektorat! Garancë dhe mbështetje për këtë duhet të kemi nga BE-ja, SHBA-ja dhe NATO, sepse shqiptarët mbështesin kërkesat e tyre PRO Referendumit, me bindje se ata do të kujdesen për statusin e shqiptarëve në Maqedoni!

Kaq!", ka shkruar një status në Facebook, gazetari Alush Kamberi.

HARMONIZIMI I TË DREJTËS SONË ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

"Neve na duhet miqësia me Amerikën, por mbi të gjitha na duhet aleanca me botën demokratike. Kosova nuk e ka fituar lirinë pse Amerika kishte miqësi të veçantë me shqiptarët, por pse në Kosovë janë shkelë brutalisht të drejtat e njeriut, është derdhur gjaku i njerëzve të pafajshëm dhe është bërë gjenocid.

Neve nuk na duhen liderë që tregojnë vullnet për t'u bërë marioneta të një administrate të caktuar, por liderë që dinë ta udhëheqin vendin drejt botës perëndimore që sublimon vlerat më të larta demokratike e civilizuese.

Duke punuar kështu, ne do të jemi në aleancë permanente me çfarëdo administrate dhe qeverie demokratike dhe nuk do të rrezikojmë humbjen e mbështetjes politike, ekonomike dhe ushtarake të vendeve të caktuara pavarësisht ndërrimit të pushteteve.

Deklarata e Presidentit Thaçi për vendosjen e ambasadës sonë në Jerusalem në rast se na njeh Izraeli, nuk është në frymën më të mirë të miqësisë dhe bashkëpunimit tonë me botën demokratike dhe më shumë e dëmton sesa e ndihmon diplomacinë tonë të brishtë dhe imazhin e shtetit të ri që pret t'i bashkohet Evropës. Ajo që ka thënë Angela Merkel se "ka ardhur koha që fatin tonë duhet ta marrim në duart tona" (fjala është për Evropën e bashkuar) vlen edhe për neve.

Fati ynë nuk guxon të varet apo të përcaktohet nga kundërshtimet dhe konfliktet e mikut tonë të madh, SHBA-së me miqtë tanë tjerë që i kemi në Evropë dhe gjithandëj botës, por nga puna jonë dhe harmonizimi i të drejtës sonë me të drejtën ndërkombëtare", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, shkrimtari nga Kosova Liri Loshi.

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE GJUHËTARI KARLO TALIIVINI?

Karlo Taliivini (1903-1982) ishte gjuhëtar i njohur italian, romanist, ballkanolog e albanolog. Mbajti për shumë vjet ligjërata të rregullta në Universitetin e Padovës për gjuhën e për letërsinë shqipe. Ka botuar monografi e artikuj për çështje të dialektologjisë, të leksikologjisë historike, të historisë së gjuhës shqipe dhe të gjuhësisë shqiptare. Ka shkruar vështrime të përgjithshme për shqipen në

enciklopedi, përmbledhje e vepra të ndryshme. Me veprën "Shqipja e Dalmacisë" dha një ndihmesë për njohjen e së folmes shqipe të Borgo Ericos (Arbëneshit) afër Zarës. Taliivini hartoi edhe një monografi dialektologjike për "Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore", në të cilën dha një parashtrim përshkrues të të folmeve shqipe të Kosovës dhe Maqedonisë.

OPOZITA ME SHPRESA TEK VOTA "KUNDËR"

A PO RELATIVIZOHEM CENSUSI?

Kryeministri Zaev dhe ministri Dimitrov kanë përkujtuar faktin se referendumi është konsultativ e jo i obligueshëm, me çka shihet një tendencë për ta relativizuar mosarritjen eventuale të censusit elektoral prej 50+1 për qind që duhet të dalin të votojnë. Ndërkaq, lideri i VMRO-së, Mickosvki assesi nuk beson se në referendum do të dalin mbi 900 mijë votues dhe që shumica prej tyre të votojnë "pro"

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 26 shtator - Kur kanë mbetur vetëm pak ditë nga mbajtja e referendumit, partitë në pushtet kanë filluar ti japin më shumë rëndësi Parlamentit ku dhe duhet të ndodhin ndryshimet kushtetuese lidhur me zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Gjatë fushatës mes pushtetit dhe opozitës, pati debat në distancë për të mirat dhe të këqijat, sipas kësaj të fundit, të Marrëveshjes me Greqinë, por jo edhe debat të mirëfilltë argumentues lidhur me referendumin. Kryeministri Zaev nuk iu përgjigj thirrjes së liderit të VMRO-së, Hristijan Mickovski, për një debat televiziv mes tyre me arsyetimin se lideri opozitar nuk ka qëndrim të qartë kundrejt referendumit.

Së fundmi, kryeministri Zaev dhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, kujtojnë faktin se referendumi është konsultativ e jo i obligueshëm, me çka shihet një tendencë për ta relativizuar mosarritjen eventuale të censusit elektoral prej 50+1 për qind që duhet të dalin të votojnë. Ndërkaq lideri i VMRO-së, Hristijan Mickovski assesi nuk beson se në referendum do të dalin mbi 900 mijë votues dhe që shumica prej tyre, të votojnë pro.

"Nëse kjo ndodhë, diçka që nuk e besoj, ai do të jetë vullnet i qytetarëve. Dhe unë nuk kam ndër mend të shkoj kundër tyre. Nuk mund të thoni se jeni demokrat dhe mos ta respektoni vullnetin e qytetarëve, por njëherësh dhe nëse nuk është i suksesshëm, atë ta respektojë pushteti", tha të mërkurën Mickovski. Por në drejtim



të ofrimit të liderit të opozitës, në shikim të parë për pjesëmarrje në referendum, por me qëllimin final që opozita të votojë ndryshimet kushtetuese, kryeministri Zaev së fundmi tregohet më shumë operues dhe miqësor me kryetarin e VMRO-së.

"Ne u pajtuam me VMRO-DPMNE-në për thujtje gjithçka dhe ashtu vepruam. Unë do të dal më 30 shtator dhe do të votoj 'për'. Duhet edhe liderët tjerë ta tregojnë qëndrimin e tyre. Nëse shumica e votave janë 'kundër', atëherë ne do ta shfuqizojmë Marrëveshjen me Greqinë, por nëse shumica janë 'për', atëherë ne duhet që t'i ndjekim udhëzimet që na i japin qytetarët", tha Zaev. Kur jemi tek censusi, analisti politik Alajdin Demiri mendon se ajo është vështirë e realizueshme për disa fakte dhe rrethana. "Në referendum votohet kur nuk kemi regjistrim të popullsisë, kur Lista zgjedhore është e ngarkuar dhe kur qytetarët nuk jetojnë në Maqedoni. Këtë e di edhe LSDM edhe të tjerët, por referendumin konsultativ më shumë e bënë për ta shpërndarë përgjegjësinë te populli dhe për larje të vetëdijes së tyre politike. Këtu nuk bëhet fjalë për pushtet, por këtu do të dihet se realisht janë brenda Maqedonisë nëse nuk ka mbushje të kutive", thotë Demiri. Siç cek ai, pavarësisht rezultatit të referendumit,

NUK KA POR, KOHA ËSHTË PËR!

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI), si organizatë e cila është aktive tash e 25 vjet në fushën e promovimit të të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe marrëdhënieve ndëretnike, konsideron se është e rëndësishme që tu drejtohem qytetarëve dhe t'i përkujtojmë ata për rëndësinë e prononcimit në referendum. "Referendumi i 30 shtatorit, është momenti kyç për marrjen e një vendimi të guximshëm dhe të pjekur! Marrëveshja me Republikën e Greqisë nuk do të thotë zgjidhje e të gjitha problemeve të shtresuara me dekada, siç është shoqëria e partizuar, etnocentrizmi, praktika e mosndëshkimit, korrupsioni. Marrëveshja është e

KONTESTI TRIDEKADËSH ËSHTË NGA FUNDI

Në fjalimin në samitin vjetor "Konkordia" në Nju-Jork, kryeministri grek Aleksis Cipras mes tjerash foli edhe për iniciativat në Ballkan, duke përmendur edhe çështjen për emrin. Kryeministri grek tha se kontesti pas pothuaj tre dekada është nga fundi, ndërsa vizioni i tij është që Greqia, si fuqi udhëheqëse, ta dërgojë tërë rajonin deri në stabilitet, bashkëpunim dhe prosperitet. "Kemi ndërmarrë iniciativat të rëndësishme që Ballkanin ta bëjmë pjesë stabile, të sigurt dhe me prosperitet të Evropës. Pamë se ekziston dritare e mundësive që të tejkalohet një çështje që ishte gjemb për Greqinë dhe Evropën pothuaj tre dekada. Çështja me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është pranë fundit. Me respektimin e historisë sonë, me respektimin e popujve tanë", tha Cipras. Kryeministri grek u përqëndrua edhe në krizën ekonomike, me të cilën ballafaqohet Greqia, duke shtuar se vendi tani e ktheu faqen dhe qëndroi në këmbë, njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina. Lidhur me problemin me refugjatët, Cipras tha se është problem evropian, për të cilin nevojitet strategji e përbashkët evropiane për ballafaqim.

politika do të zhvendoset në Parlament dhe po aty do të jetë ballafaqimi i vërtetë mes pushtetit dhe opozitës që nëse nuk na çojnë në ndryshime kushtetuese, është e sigurt se do të na çojnë në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

"VMRO bënë një lojë shumë të pistë politike, duke mos u deklaruar për pjesëmarrje në referendum. VMRO dëshiron të mbetemi me IRJM dhe të kthehet në pozitë politike për të marrë pushtetin. Kjo parti ka frikë të deklarohet kundër referendumit, për arsye se do të mund të zhbëhet nga lista e partive pro integriteteve euroatlantike", thekson Demiri. Sipas tij, nëse shumica dërmuese deri në 90 për qind

votojnë pro në referendum, edhe nëse nuk ka census, kjo mund të bëjë që VMRO të bëhet pjesë e ndryshimeve kushtetuese. Në rast se votat "kundër" do të jenë në masë të konsiderueshme në referendum, VMRO mund të mos votojë për ndryshime kushtetuese dhe të kërkojë më këmbëngulje zgjedhje të parakohshme.

"Zgjedhje të parakohshme gjithsesi do të kemi, pasi që do të kemi realitet të ri politik dhe ato do ti kërkojë edhe vetë kryeministri Zaev në rast se ka sukses referendumi dhe kalojnë ndryshimet kushtetuese. Këtë do ta bëjë edhe për të rritur shumicën parlamentare", shprehet i sigurt Demiri.

GATI 12.500 VËZHgues DO TA NDJEKIN REFERENDUMIN

Numër rekord i vëzhguesve vendorë dhe të huaj do të jenë në vendvotime të dielën më 30 shtator që ta ndjekin procesin e prononcimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë për çështjen e referendumit. Numri zyrtar nga KSHZ-ja e vëzhguesve vendorë është 11.907, ndërsa vëzhguesve të huaj është 493, ndërsa organizatat ndërkombëtare kanë akredituar edhe 194 përkthyes. Krahas gazetarëve vendorë, referendumin do ta ndjekin edhe gazetarë të huaj. KSHZ ka akredituar 83 gazetarë nga 32 media, por, siç informojnë nga atje, disa gazetarë janë refuzuar për shkak të asaj që kanë parashtruar kërkesë për kreditime pas skadimit të afatit i cili përfundoi më 24 shtator në mesnatë.

Lidhur me gjendjen reale të votuesve në Maqedoni dhe sa prej tyre mund të dalin të votojnë pro, ka folur ish-kryeministri Vllado Buçkovski. "Referendumi për emrin është një moment historik për Maqedoninë, drejtuar drejt zgjedhjes për aderim në BE-së. Për fat të keq, marrëveshja me Greqinë ishte zgjidhja e vetme e mundshme që ta hapim derën e BE-së. Është e qartë se mbi 700 mijë qytetarë të Maqedonisë do të votojnë 'për', por për momentin nuk dihet se a do të bashkohen ata të cilët janë kundër", thotë Buçkovski. Ai pajtohet se referendumi aktual është vazhdimësi e atij të vitit 1991. "Atëherë luftonim për pavarësi, sot luftojmë që të jemi pjesë e NATO-s dhe BE-së. Do ta konfirmojmë shtetësinë tonë", është decid Buçkovski. Sipas vlerësimit të tij, të dhënë në emision, për momentin në Maqedoni ka nga 1.300.000 deri në 1.350.000 votues. Nga ana tjetër, 250.000 deri në 300.000 janë votues të papërcaktuar të cilët nuk besojnë në politikanët dhe sipas gjitha gjasave, nuk kishin votuar në zgjedhjet e fundit. "Besoj se fushata momentale do t'i inkurajojë që të dalin në votim", tha ish-kryeministri i Maqedonisë Buçkovski.

KËSHILLI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË FTON QYTETARËT TË VOTOJNË REFERENDUMIN

MBËSHTETJE PËR 30 SHTATORIN



Referendumin e 30 shtatorit e mbështesin edhe intelektualët shqiptarë të ardhur nga Amerika, të cilët thonë që dëshirojnë që Maqedoninë ta shohin sa më afër NATOS dhe BE-së

Koha

Qefsere ABDYLI

Shkup, 26 shtator - Këshilli i Intelektualëve Shqiptarë në Maqedoni, me rastin e Referendumit i cili pritet të mbahet më 30 shtatorë, dje mbajti një konferencë për shtyp, ku paraqiti kërkesa, arsyetime si edhe një memorandum. Kërkesa e tyre ishte që me ndryshimin e Kushtetutë së Republikës së Maqedonisë të rregullohet dhe garantohet statusi juridik-kushtetues dhe politik i popullit shqiptarë në Maqedoni.

"Republika e Maqedonisë është shtet nacional i popullit maqedonas, shtet i popullit shqiptar, si dhe bashkësive etnike, turke, vllehe, bullgare, serbe, rome, boshnjake dhe të tjera që jetojnë në këtë shtet. Presim që me ndryshimet kushtetuese në tërë territorin e RM-së, dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare të jenë gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik si dhe gjuha shqipe dhe

shkrimi i saj", thanë nga Këshilli i Intelektualëve Shqiptarë. Po nga ky këshill kanë disa arsyetime, pasi sipas tyre, me Kushtetutën e vitit 1991 nuk u përfillën të drejtat kolektive të popullit shqiptar në Maqedoni, dhe kjo ka qenë diskriminuese për shqiptarët si dhe për bashkësitë e tjera etnike pakicë që jetojnë në Maqedoni. "Këshilli i Intelektualëve shqiptarë në Maqedoni, duke e shqyrtuar situatën e krijuar me nënshkrimin e Marrëveshjes për fqinjësi të mire me Greqinë dhe polarizimet rreth kësaj marrëveshjeje në shtet lidhur me referendumin e 30 shtatorit për anëtarësimin e Maqedonisë në

NATO dhe BE, pranimin e Marrëveshjes së Prespës me Greqinë, e konsiderojnë kusht për integrimin euroatlantike duke ndryshuar emrin kushtetues të shtetit", theksuan nga ky këshill. Referendumin e 30 shtatorit e mbështesin edhe intelektualët shqiptarë të ardhur nga Amerika, të cilët dëshirojnë që Maqedoninë ta shohin sa më afër NATOS dhe BE-së, gjithashtu nga aty u apelua që të gjithë qytetarët të dalin sa më masovikisht të votojnë referendumin pasi për herë të parë në historinë e vendit tonë po realizohet një diçka e cila është në të mirën e tyre.

LETËRNJOFTIME MUND TË NXIRRNË EDHE TË SHTUNËN DHE TË DIELËN

Ministria e Punëve të Brendshme i njofton qytetarët se në të gjithë Sektorët për punë administrative do të punojnë të shtunën dhe të dielën (29 dhe 30.09.2018). Të gjitha kërkesat për dhënie e letërnjoftimit (të dëmtuar, të humbur ose të vjedhur) sipas procedurës së zbatuar ligjore, do të miratohen urgjentisht dhe në të gjithë Sektorët rajonal për punë administrative në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe atë vetëm nëse parashtruesi nuk posedon dokumentin biometrik të udhëtimit. "Kërkesat për letërnjoftime do të pranohen dhe miratohen urgjentisht përfshirë të shtunën (29.09.2018) deri në orën 16:30. Menjëherë pas pranimit të aplikacioneve për letërnjoftime, Sektori për informatikë do t'i përpunojë dhe do t'ia dorëzojë sektorit kompetent për shpërndarje me kohë deri në Sektorin për punë administrative. Në ditën e referendumit (e diel, 30.09.2018) Sektorët për punë administrative do të punojnë vetëm për dhënie e letërnjoftimeve në periudhë prej orës 7:00 deri në orën 19:00", kumtoi MPB.



Çdo pengim i të drejtës së votimit do të sanksionohet

Shkup, 26 shtator - Policia është në krye të detyrës që të mundësojë ambient demokratik votues dhe shprehje të lirë të vullnetit të qytetarëve, fshehtësia e votës është e garantuar, tha ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, në konferencën për shtyp pas vizitës së djeshme në SPB Shtip dhe në vetëqeverisjen lokale. Ai i informoi mediat se në takimin me udhëheqësin e SPB Shtip është biseduar për referendumin vijues të dielën dhe masat të cilat MPB i ndërmerret që gjithçka të kalojë në rendin më të mirë gjegjësisht të mundësojë shprehje të lirë të vullnetit të qytetarëve.

Në pajtueshmëri me ligjet, tha, çdo lloj presioni, kanosje ose shantazhi gjatë aktit të votimit do të pengohet dhe sanksionohet. "Çdo tentim për pengim të realizimit të së drejtës së votës do të sanksionohet", tha Spasovski, duke shtuar se e drejta e votës është e pacenueshme dhe se askush nuk guxon ta rrezikojë. Në takimin në SPB Shtip është biseduar edhe për gjendjen e sigurisë në këtë rajon dhe është konstatuar se ajo është stabile dhe po vërehet përmirësim në punë.

Në tre muajt e fundit ka rritje të aktivitetit zbulues në sferën e krimit ekonomik, tregtisë së palejuar me drogë dhe sfera të tjera. Është biseduar edhe për gjendjen në komunikacion dhe masat dhe aktivitetet që ndërmerren përmes kontrolleve të vazhdueshme të aksioneve për sanksionim të kundërvajtjeve në komunikacion, por edhe aktivitetet parandaluese me qëllim të ngritjes së vetëdijes për respektim të rregullave në komunikacion. Në takimin me kryetarin e komunës së Shtipit Bllagoj Boçvarski është konstatuar bashkëpunimi i shkëlqyeshëm midis MPB-së dhe komunës së Shtipit, ndërsa është biseduar edhe për avancim plotësues të këtij bashkëpunimi, posaçërisht në pjesën e komunikacionit dhe tanimë janë detajuar edhe aktivitetet konkrete.

KRERËT E QEVERISË TAKOJNË BIZNESIN SHQIPTARË

OEMVP për referendum të suksesshëm

Shkup, 26 shtator - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) dhe të gjithë anëtarët e kësaj Odës fuqishëm mbështesin referendumin e 30 shtatorit dhe do të votojnë pro referendumit, pasi me hyrjen e Maqedonisë në BE dhe NATO, do të ketë stabilitet dhe siguri më të madhe për biznesin dhe pjesëmarrje më të lirë në tregjet e treta. Kështu deklaroi kryetari i OEMVP-së, Nebi Hoxha, pas takimit që pati me zëvendëskryeministrin për çështje evropiane, Bujar Osmani, i cili së bashku me ministrin për Arsime dhe Shkencë, Arbër Ademi, atë të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi dhe zëvendëskryeministrin e Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu, për së



afërmi i njoftuan anëtarët e OEMVP-së me perspektivat evropiane, potencialet dhe përfitimet për biznesin në procesin e negociatave, si dhe nga vetë anëtarësi-

mi i Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Hoxha edhe njëherë shprehu qartë qëndrimin e tyre se kompanitë janë "për" referendumin dhe

se presin rezultat pozitiv, ndërkohë që pas votimit, kompanitë vendore presin që Qeveria ta intensifikojë bashkëpunimin me Odat për përmirësimin e ambientit të biznesit. "Çdo stabilitet dhe siguri e shtetit do të thotë perspektivë për biznesin. Anëtarësimi në BE dhe në NATO nga ky aspekt është shumë i rëndësishëm. Ne jemi 'për' referendumin, sepse përfitimet do të jenë të mëdha jo vetëm për ne, por edhe për të gjitha vendet e rajonit", tha kryetari i OEMVP-së. Situata me referendumin është bardh e zi, u shpreh zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani

"Situata me referendumin është bardh e zi, nuk ka nuanca,

sepse vendimi është për një standard më të mirë ekonomik dhe klimë më të mirë të biznesit apo ngecje. Vendimin që do ta marrim do të jetë dramatikisht pozitiv nëse referendumi është i suksesshëm, sepse anëtarësimi në NATO do të thotë stabilitet dhe parashikueshmëri politike, ndërsa anëtarësimi në tregun e BE-së prej 500 milionë me pjesë më të madhe të BPV-së në botë. Dramatikisht negativ do të jetë nëse, hipotetiki, referendumin nuk ka sukses, sepse do të vijojë paparashikueshmëria, mungesa e investimeve të huaja, mospasje të guximit për investime vendore e që do të reflektohet mbi zhvillimin ekonomik të qytetarëve", deklaroi Osmani. (Z.V)

PËRFUNDON PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË ANSAMBLIT



NË KËRKIM TË SELISË

Procedurat për regjistrimin si institucion nacional në Regjistrin Qendror kanë përfunduar vetëm një ditë më parë (të martën) dhe vonesat lidhen me mospasjen e një adrese, në aktin e themelimit figuronte "pn" (pa numër). Por edhe në Regjistër Ansambli si adresë provizore ka komunën e Çairit, deri në sigurimin e një lokacioni të përshtatshëm për funksionimin e tij. Salla sportive "Partizani", pranë stadiumit në Çair, aty ku duhej të vendosej ansambli është një variant që është hedhur poshtë dhe duhet që Qeveria të japë miratimin për një vend tjetër

Koha

Evis HALILI

Shkup, 26 shtator - Shtatori ishte muaji kur Ansambli i Këngëve dhe Valleve Shqipe do të duhej të ngjitej për herë të parë në skenë, të paktën sipas paralajmërimeve të Ministrisë së Kulturës disa muaj më parë. Por në fakt ende është në kërkim të një selie dhe kompletimit me instrumente, përzgjedhjen e punonjësve... Procedurat për regjistrimin si institucion nacional në Regjistrin Qendror kanë përfunduar vetëm një ditë më parë (të martën) dhe vonesa prej më shumë se gjashtë muajsh lidhen me mospasjen e një adrese, në aktin e themelimit figuronte pn (pa numër). Por edhe në Regjistër Ansambli si adresë provizore ka komunën e Çairit, deri në sigurimin e një lokacioni të përshtatshëm për funksionimin e tij. Salla sportive "Partizani", pranë stadiumit në Çair, aty ku duhej të vendosej ansambli është një variant që është hedhur poshtë dhe duhet që Qeveria të japë mi-

ratimin për një vend tjetër.

"Procedurat për themelimin e këtij institucioni parashikohen të kompletohen brenda gjatë muajve, ndërsa në fund të muajit shtator planifikohet të jepet edhe koncerti i parë", pati deklaruar sekretari shtetëror në Ministrinë e Kulturës, Valmir Aziri.

Por sipas drejtorit Fatos Lumani, që është emëruar në këtë post që në muaji prill, gjasat për prezantimin e parë mund të jenë në muajin nëntor, me rastin e festave, por edhe vitin tjetër. Regjistrimi me vonesë shkaktoi një zinxhir problemesh dhe zvarritjesh për të filluar me punë në datën e përcaktuar.

"Mbas regjistrimit do kemi eksperimente në gjithë Maqedoninë, ku do t'i takojmë të gjithë ansamblet dhe individët për t'u informuar nga afër për gjendjen e kuadrit të mundshëm për ansambël, si dhe të formulojmë mendim në lidhje me rregullat e pranimit të kuadrit profesional", thotë Lumani.

Vendimi për themelimin e Ansambli të këngëve dhe valleve shqipe, si një organizatë jofitimruese në fushën e kulturës - në kategorinë institucionit nacional, që do të financohet nga buxheti i shteti, u miratua nga Qeveria në muajin mars, ose tre muaj pas ini-

ciativës për themelimin. Me gjithsej 96 të punësuar, mes të cilëve 18 çifte valltarësh dhe një buxhet prej 51 milionë denarë, fond ky që do të vihet në dispozicion për pagesat e punonjësve, blerjen e 23 instrumenteve (804 mijë denarë), kostumeve (mbi 2 milionë denarë), autobusin (3 milionë denarë), ndërsa një pjesë tjetër ishte parashikuar për rikonstruktimin e ambienteve dhe adaptimin e tyre sipas nevojave të ansambli (7 milionë denarë). Ansambli përbëhet nga dy sektorë (juridik dhe financiar) udhëheqësin programor, si edhe pesë të tjerë: juridik, teknik, instrumental, të valles dhe atë të vokalit.

Në vendimin e Qeverisë, ndër të tjera thuhet se ky institucion do të afirmojë vlerat e folklorit shqiptar, traditën dhe kulturën, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, si edhe do të nxisë rininë që të kultivojë dhe të praktikojë folklorin. Qëllimi për formimin e këtij institucioni ka lindur nga nevoja për të ruajtur në mënyrë institucionale folklorin shqiptar, financimi dhe interesimi për të cilin ka qenë minimal, por edhe për të ruajtur veshjet tradicionale origjinale, si edhe për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për trashëgiminë jomateriale.

VAZHDOJNË SHQYRTIMET E ANKESAVE

Pak ditë përpara shpalljes së Konkursit për Programin e vitit 2019 të kulturës Ministria e Kulturës është ende në fazën e shqyrtimit të ankesave për Programin e vitit 2018. Të pyetur nga KOHA ato pohojnë se deri tani janë realizuar 75 për qind të mjeteve të planifikuara buxhetore dhe deri në fund të vitit duhet të realizohet edhe pjesa e mbetur. "Ankesa lidhur me Programin kishte dhe të njëjtat në pajtim me procedurën ligjore janë duke u shqyrtuar nga komisionet gjegjëse, para se të dorëzohen në Komisionin Shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në Shkallë të Dytë. Kontrata për realizimin e projekteve lidhet me ata pjesëmarrës të Konkursit ankesat e të cilëve pas rishqyrtimit nga komisionet e Ministrisë së Kulturës, do të vendoset të pranohen. Ankesat tjera dorëzohen në Komisionin Shtetëror për vendosje në Shkallë të Dytë, i cili vendos lidhur me ato ankesa dhe për vendimin e tij i informon parashtruesit e ankesave dhe Ministrinë e Kulturës", deklaroi nga kabineti i ministrit. Deri më tani Komisioni i Shkallës së Dytë ka marrë përgjigje për një pjesë të projekteve të cilat nuk kanë marrë mbështetje, siç është vendosur edhe në Ministrinë e Kulturës, kurse për një numër të ankesave akoma presin përgjigje.

KRONIKË

Kapen 6 valltare në Oriental As

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, mbrëmë në periudhën kohore prej orës 22.00 deri 01.00 pas mesnate, kanë realizuar kontroll aksion në objektin hotelierik "Oriental-AS" me lokacion për rreth autostradës Gostivar-Tetovë, në fshatin Zherovjan, pronë e 28-vjeçarit nga Bogovina. Gjatë kontrollit, në objekt janë ndaluar gjashtë femra (valltare), nga të cilat 3 shtetase të Serbisë dhe 3 shtetase të Maqedonisë. Tre shtetaset e Serbisë të moshës dy 21 vjeçare dhe njëra 26 vjeçare, janë mbajtur në Stacionin policorë Tetovë, dhe pas dokumentimit të plotë të rastit, janë dorëzuar në Njësitin për krime ndërkufitare, të huaj, migracion dhe riatdhesim, për procedurë të mëtutjeshme, njofton SPB në Tetovë.

Rrahje me grushta, 44-vjeçari përfundon në spital

Dje rreth orës 13.00 në rrugën e Ilindenit në Tetovë, është prishur rendi dhe qetësia publike, gjatë një përleshjeje e cila ka ndodhur, në mes të personit me initiale S.B. 20-vjeçarë nga fshati Strimnicë, dhe 44-vjeçarit F.I. nga i njëjti fshat. Gjatë përleshjes, S.B. i cili së pari ka qenë i sulmuar nga personi F.I. i është kundërpërgjigjur në të njëjtën mënyrë dhe disa herë e ka grushtuar në pjesën e kokës, pas çka për pasojë, F.I. ka humbur vetëdijen dhe pas dhënies së ndihmës mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës, për shkak të seriozitetit të plagëve, me autoambulancë është transferuar për në klinikat e Shkupit. Njëzetvjeçari S.B. është privuar nga liria dhe mbajtur në Stacionin policorë në Tetovë. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit njofton policia e Tetovës.

Në një "Opel" gjenden emigrantë nga Irani

Në autostradën Shkup-Gjevgjeli në aksin nga Negotina për në Gjevgjeli në një automjet "opel zafira" me traga të Shkupit janë gjetur nëntë emigrantë nga Irani. Siç njoftoi sot MPB-ja, policia ka pasur dijeni se dy automjete, një "opel zafira" me traga të Shkupit dhe një "BMW" me targa të Shkupit kanë transportuar emigrantë. Nëpunësit e policisë kanë dhënë shenjë për ndalimin e automjeteve por ato nuk kanë ndaluar. Ndërkohë "opeli" ka vazhduar rrugën drejt kalimit kufitar "Bogorocë" dhe është përplasur me një shtyllë metali. Shoferi është larguar nga vendi i ngjarjes, por pas masave të ndërmarra dhe aktivitetëve në orën 22.00 është gjetur dhe është privuar nga liria. Bëhet fjalë për personin E.J. (25) nga Gjermania, ndërsa me vendbanim në fshatin Orlanc, citohet në njoftim. Merren masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Kapen nxënësit që kërcënonin me armë

Dy 15-vjeçarë minorenë nga fshati Kopaçindoll, nxënës të shkollës së mesme, në prezencë të familjarëve të tyre, dje rreth orës 13 e 40 minuta, në Stacionin policorë Tetovë kanë denoncuar rrezikim me armë gjatë një përleshje verbale, të cilën e kanë kryer dy persona nga fshati Cajre, të moshës 15 dhe 16 vjeçare. Në mëngjesin e ditës së djeshme, rreth orës 09.00, përderisa kanë lëvizur në rrugën "Vëllezrit Miladinovi" në Tetovë, janë afruar dy personat e denoncuar nga të cilët njëri (15 vjeçari) nxënës në të njëjtën shkollë, ka nxjerrë një pistoletë, është kërcënuar dhe e ka drejtuar në drejtim të tyre, derisa tjetri ka mbajtur një thikë në dorë me qëllim që ti sulmoj. Kalimtarë të rastit kanë reaguar dhe i kanë ndarë, kurse dy minorenët nga fshati Cajre menjëherë kanë ikur dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes, por më vonë janë thirrur në Stacionin policorë në Tetovë. Policia informon se është duke u zbardhur. (U.H)

Nga Zaevi e deri te Mogerini, Çarshia e Shkupit ditëve të kaluara ka qenë në qendër të vëmendjes. Por, fatkeqësisht - vizitat e shumta të funksionarëve qeveritar nuk japin shpresë, aq më pak ndonjë paralajmërim se pushteti ka ndonjë projekt kapital për këtë pjesë të Shkupit të vjetër

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 shtator - Çarshia e Shkupit gjatë periudhës së fundit ka qenë pjesë e agjendave ditore të shumë funksionarëve të lartë shtetëror. Në prag të referendumit, nëpër kalldrëmin e saj javëve të fundit pothuajse ka kaluar i gjithë kori diplomatik. Ndonëse kryeministri Zoran Zaev dhe kabineti i tij gati për çdo ditë kanë qëndruar në Çarshi, mirëpo vizita e cila bëri më tepër bujë ishte ajo e përfaqësues së lartë të Bashkimit Evropian, Frederika Mogerinit. Defilimi i shumë funksionarëve të lartë shtetëror të vendit tonë, por edhe të huajve nëpër rrugicat e çarshisë, tregon qartë se ky kompleks historik ka peshë të madhe kulturore. Megjithatë, realiteti në të cilën për momentin gjendet dhe zhvillohet Çarshia e Shkupit, fatkeqësisht i ngjanë një anarkie të plotë. Për shumicën e esnafit të Çarshisë, prezencja e pushtetarëve nuk është një tregues se diçka mund të përmirësohet në këtë pjesë historike të Shkupit.

Keqpërdorimi i imazhit të Çarshisë për arritjen e një qëllimi të caktuar, siç shprehen dy-

ÇARSHIA E SHKUPIT SKENË E PROMOVIMIT, POR JO E INVESTIMEVE

FUSHATË EDHE ME ÇARSHINË



qanxhinjtë, vazhdon të bëhet vit pas viti. Ndërkohë kujdesi institucional dhe sundimi i Ligjit në këtë anë të kryeqyteti pothuajse fare nuk ekzistojnë. Mungesa e pastërtisë, sigurisë dhe ndriçimit në orët e natës përfshinë vetëm një pjesë të kaosit që funksionon në këtë pjesë të Shkupit. Nga ana tjetër, rrëni i objekteve historike dhe ngritja e "kullave" brenda natës, respektivisht uzurpimi i hapësirës publike paraqet temë në vetë.

Njëri prej zërave më kritik kur bëhet fjalë për statusin e Çarshisë së Shkupit dhe gjendjes së tij, pa dyshim është esnafi i moçëm Diamant Nagavci. Kur flet për situatën e viteve të fundit në Çarshi, ai për gazetën KOHA, shprehet i zhgënjyer për degradimin që i

bëhet këtij monumenti historik. Fluksin e madh të pushtetarëve në çarshi, Nagavci e ndërlihd me pronën të cilën shteti vazhdon të ketë në posedim, gjegjësisht ai shton se Maqedonia nga vitet e 90-ta e këndej me qëllim apo pa qëllim nuk ka përpiluar asnjë program për ri ngritjen e këtij kompleksi.

"Çdo tridhet vite, Çarshia kalon

nëpër disa faza të rënies, ngritjes (shkëlqimit), respektivisht shkatërrimit dhe ndërtimit. Fatkeqësisht, edhe pse kjo nuk duhet të ndodhë, megjithatë zhvillimet politike brenda në shtet dhe rajon kanë ndikuar shumë që kjo qendër e dikurshme ekonomike të dëmtohet skajshmërisht. Për momentin jemi duke kaluar fazën kur pu-

shtetet si ky i sodit dhe ato të mëhershmit nuk kanë plan të ndërtimit të një Strategjie për funksionimin e plotë të saj. Faji i shtetit në krijimin e këtij kaosi në Çarshi është se një pjesë bukur e mirë e dyqaneve janë në pronë e saj, pastaj pronë e Bashkësisë Fetare Islame dhe një pjesë tjetër në pronë të Kishës Ortodokse, gjegjësisht me keqpërdorimin e këtyre pronave është krijuar edhe kaosi urban dhe ai kulturor", thotë Nagavci.

Ndryshe, në vitin 2008 në Parlament i miratua Ligji për mbrojtjen e Çarshisë së Shkupi si pjesë posaçme e trashëgimisë kulturore. Qëllimi primar i këtij Ligji, siç njoftuan atëherë zyrtarët, ishte mbrojtja e atyre objekteve me rëndësi të veçantë kulturore, mbikëqyrje e punimeve dhe zhvillimeve të përgjithshme që lidhen me të kaluarën e saj historike. Por, opinioni gjatë këtyre 15 viteve të kaluara është dëshmitar se në Çarshi janë shkelur e dispozita të shumta ligjore dhe procedura të ndryshme gjatë revitalizimit apo ndërtimit të objekteve të reja.

QENTË ENDACAK IMAZHI I KEQ PËR ÇARSHINË

Tufa qensh endacak mund të shihen gati nëpër çdo cep të Çarshisë në Shkup. Prezencja e tyre më së shumti mund të vërehet në orët e natës. Për këtë arsye, shumë qytetar nëpër rrjetet sociale kanë shprehur vërejtjet e tyre për qarkullimin e këtyre qenve endacak. Reagimet e opinionit për këtë problematike kryesisht lidhen me frikën nga sulmet eventuale që mund ti bëjnë ata. Përveç

esnafit dhe dyqanxhinjve të Çarshisë që ballafaqohen me këto problem, kritikën për qentë endacak në adresë të autoriteteve lokale mund të vërehen edhe nga shumë pjesë tjera të kryeqytetit. Megjithatë, për dallim nga vendet tjera, qentë endacak përpos që ndikojnë në frikësimin e qytetarëve në Çarshi, ata më tepër e ulin imazhin turistik që e ka ky vend.

Më shumë se një e treta e qytetarëve flasin një gjuhë të huaj

Bruksel, 26 shtator - Në vitin 2016, 38 për qind e qytetarëve të Maqedonisë, midis 25 dhe 64 vjeç, kanë thënë se kanë njohur nga një gjuhë e huaj. Kur bëhet fjalë për njohje të dy gjuhëve të huaja ky numër pëson rënie në 20 për qind, ndërsa vetëm nëntë për qind e qytetarëve të Maqedonisë kanë njohur nga tre ose më shumë gjuhë të huaja, tregojnë të dhënat e fundit të Institutit Evropian për Statistikë - EUROSTAT, të publikuara me rastin e Ditës Evropiane të Gjuhëve. Maqedonia shënon rezultate më të këqija nga BE-ja në tërësi, por më të mira nga disa vende-anëtare të Unionit. Në nivel të BE-së, 65 për qind e qytetarëve thonë se njohin një gjuhë të huaj, tregon Eurostat. Pas vendeve-anëtare, rezultate më të mira shënojnë Suedia me 97 për qind, Letonia, Danimarka dhe Lituania me 96 për qind, Luksemburgu me 95 për qind, Finlanda dhe Malta me 92 për qind dhe Estonia me 91 për qind. Finlanda dhe Sllovenia, madje, kanë shifra më të larta lidhur me njohjen e tre ose më shumë gjuhëve të huaja (45 dhe 38 për qind). Njohje më të ulët të gjuhëve të huaja ka në Britani të Madhe ku vetëm 35 për qind e qytetarëve njohin një gjuhë të huaj, pastaj Rumania me 36 për qind, Hungaria 42 për qind dhe Bullgaria ku gjysma e popullatës nuk njeh asnjë gjuhë të huaj.

KOMPANIA GJERMANE GATI FAZËN E DYTË TË INVESTIMIT

ODV Elektrik nis me 90 punësime dhe 4.2 milionë euro

Shkup, 26 shtator - Nëntëdhjetë vende të reja pune do të hapen me investimin prej 4.2 milionë euro që kompania gjermane ODV Elektrik do t'i investojë në fazën e dytë të investimit në Maqedoni. Drejtori ekzekutiv i kompanisë Martin Ekrev, dje në Qeveri, pas nënshkrimit të Memorandumit, tha se planet e tyre janë që të vazhdojnë të investojnë në Maqedoni dhe të investojnë gjithsej rreth 15 milionë euro dhe të hapin më shumë se një mijë vende pune. "ODV Elektrik ka vendosur të investojë në Maqedoni prej disa arsyeve. Maqedonia është afër Evropës Qendrore, jetojmë në zonën e njëjtë kohore, ndajmë kulturë dhe vlera të përbashkëta. Këtu ka punëtorë të aftë, ndërsa ligjet, rregullativat dhe të dhënat doganore tashmë janë harmonizuar me ata të BE-së. Përveç kësaj, kemi edhe mbështetje të fortë institucionale në Maqedoni", theksoi Ekrev. Për zëvendëskryeministrin për Çështje Ekonomike, Koço Angjueshev, është mirë që me investimin e ri do të punësohen persona me kualifikim të lartë.



"Nevojiten investime, por nevojiten edhe ndryshim në sistemin arsimor sepse kuadri që për momentin është i papunë nuk është përkatës për nevojat e ekonomisë. Për këtë shkak Qeveria do të punojë paralelisht në disa masa për në mënyrë akute ta zgjidh problemin", tha Angjueshev. Ai vlerësoi se politikat e deritanishme qeveritare japin rezultate për çfarë tregues janë 17 investimet e reja, ulja e papunësisë, rriten pagat të cilat për gjysmën e parë të vitit janë rritur për 6.2 për qind në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa janë rritur edhe investimet e huaja të cilat në gjy-

smëvjedorin e parë janë 327 milionë euro dhe disa herë janë rritur në krahasim me vitin e kaluar.

ODV Elektrik tashmë punon në ZZHTI Ohër/Strugë. Në fazën e parë ka investuar 4,5 milionë euro dhe ka punësuar rreth 310 persona. Në fabrikën në ZZHTI Ohër/Strugë prodhon instalime elektrike për brende të njohura automobilistike. Kompania është themeluar në vitin 1970 edhe krahas fabrikës në Gjermani ka edhe katër filiale shtesë në pjesën jugore të Hungarisë, pjesën perëndimore të Ukrainës, Maqedoni dhe në Meksikë. (Z.V)

Janë me mijëra banorë të Malësisë së Tetovës që kanë braktisur vatrat e tyre për një jetë më të mirë në vendet evropiane, duke lënë shtëpitë e tyre të pabanuara, dhe kjo do të ishte mundësi e mirë që të njëjtat të shndërrohen në bujtina, hotele, restorante për vizitorë të huaj... Megjithatë, Qeveritë po vijnë dhe shkojnë, ndërsa askush nuk investon në Malin Sharr

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 26 shtator - Masivi i Sharrit krahas bukurisë dhe pasurisë natyrore, paraqet edhe vendbanim për shumë qytetarë autokton që nga periudhat e mëhershme. Janë me dhjetëra fshatra që gravitojnë në Malësinë e Sharrit, duke filluar nga Jazhinca e deri në Gostivar. Pikërisht në këtë masiv malor, janë me dhjetëra, liqene, ujëvara, lumenj, bimë dhe shtazë të rralla, vendbanime të rralla që kanë ruajtur arkitekturën tradicionale e kështu me radhë. E tërë kjo pasuri natyrore që është prekur nga dora e njeriut dhe e cila e ka shkatërruar me prerjen e dunjve, vazhdon të jetë e pa eksploruar dhe e mbyllur hermetikisht për turistët. Banorë, profesorë dhe shoqata joqeveritare shprehen se mungon interesimi i shtetit, por edhe i autoriteteve lokale që kjo zonë të zhvillohet në një atraksion turistik.

Hisen Xhemaili, thotë krahas shumë përparësive, ka edhe mosinteresi që Sharri të jetë destinacion për turistë të huaj të apasionuar pas bukurive të malit. "Mali Sharr bazuar në resurset natyrore, ka shumë mundësi për zhvillim të turizmit. Paraqet një regjion që gjithsesi duhet mbrojtur dhe shfrytëzuar për qëllime ekonomike, turistike, shkencore dhe edukative. Format e shumta dhe të llojllojshme morfologjike - cirqet, lumenjtë, liqenet, morenat, luginat e akullnajave, grykat, kanionet, shpellat dhe peizazhet atraktive relievo... mund të shfrytëzohen për qëllime turistike. Aktualisht mungojnë kapacitetet e akomodimit në vendbanimet brenda Malit Sharr në fshatrat e Malësisë, nuk ka informacione të mjaftueshme, ndërsa agjencitë turistike nuk e kanë të përfshirë në ofertat turistike për akomodim", thotë Xhemaili, sipas të cilit, përveç Qendrës "Kodra e Diellit", nuk ka kapacitete akomoduese tjera, kurse duhet shteti të subvencionojë edhe shtëpitë private njëjtë sikurse në Ohër që, nëse mban turistë, të ketë një shumë të caktuar të hollash.

"Momentalisht janë disa bujtina në shtëpitë e alpinistëve në Lu-

POTENCIALE KA, MUNGOJNË INVESTIMET

DORA E SHTETIT NUK E PREK MALIN SHARR



boten, në Kobilicë, një në Kodër të Diellit dhe tjera nuk ka", thotë Xhemaili, ish-kryetar i Këshillit të Komunës së Tetovës. Banorët shprehen se në Malin Sharr ka kapacitete për zhvillimin e turizmit malor, madje kjo do të ishte një mënyrë e mirë që të parandalonte shpërnguljen masive të banorë.

Emin Denjalli, ish-kryetar i Bashkësisë Lokale të fshatit Veshallë, shprehet se me shumë pak punë, mund të arrihet që të zhvillohet turizmi malor. "Malësia e Sharrit ka resurse të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit malor. Megjithatë, popullata jonë shumë më lehtë e kishte të punoj si punëtor krahu kudo të jetë se sa të merret me turizëm në vend të vet. E them me gojë plot se ka kushte për turizëm malor duke patur parasysh ujin e pastër dhe të mjaftueshëm. Nuk mungojnë as flora dhe as fauna, të cilat i ke të shpërndara gjithandej dhe është e dukshme se Mali Sharr është i veshur dhe me pyje të ndryshme, ndërsa ka edhe shumë bimë dhe shtazë që zhvillohen vetëm në

Malin Sharr. Zonat malore janë të paprekshme, tani shumë pak punohet toka dhe kultivohet blegtoaria edhe pse në këto zona mund të zhvillohet edhe peshkataria për shkak të lumenjve", thotë Denjalli, i cili sqaron se shumë rrugë të cilët kanë filluar të ndërtohen janë devijuar duke pamundësuar zhvillimin e turizmit.

Nexhbedin Haliti, një aktivist për promovimin e Malin Sharr, shprehet se mungesa e infrastrukturës ka bërë që të mos zhvillohet turizmi.

"Mungesa e investimeve dhe sidomos e infrastrukturës mbajnë peng edhe mundësinë e zhvillimit turistik të kësaj zone me vlera të mëdha natyrore. Atraksionet e veçanta në bjeshkët e Sharrit janë sytë e Sharrit, apo janë 39 liqenet e Sharrit, ujëvara në Leshnicë, Skakallë, Bellovisht dhe në Vicë... Kanionet në Xhinibegj, Leshnicë e Epërme, Çaushicë dhe Vracë. Masivet gurorë në Pllat, Xhinibegj, Piribeg, Çelepinë dhe në Kubilicë dhe lumenjtë Shkumbini, Muzdaçja, Bi-

strica, lumi i Bogovinës dhe lumi i Vicës", thotë Haliti. Ai shprehet se nëse ka një interesim më të madh, kjo është një mundësi e madhe që të lulëzojë turizmi malor.

"Nëse kombinohet natyra e mrekullueshme dhe bujaria e njerëzve, edhe pse skajshmërisht të varfër, Sharri paraqet një potencial për turizëm të qëndrueshëm, qoftë ai turizëm malor, Eko-turizëm, turizëm aventurash, eksplorim, apo format tjera të turizmit që zbatohet sot në Europë apo edhe në vendet e Ballkanit, si në Bullgari, Shqipëri etj", shprehet Haliti nga OJQ "Eko-Natyrë" Tetovë.

Në ndërkohë, organizatat që merren me promovimin e bukurive të Malit Sharr dhe që janë pjesë e iniciativës për shpalljen e të njëjtit si park kombëtar, shprehen se mungon infrastruktura për zhvillim të turizmit malor. Ata thonë se mungon edukimi i popullatës lokale dhe promovimi në nivel ndërkombëtar.

"Problemi kryesor për mos zhvillim të turizmit malor ka ardhur si rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe suprastrukturës së dobët turistike përgjatë tërë territorit në Malin Sharr. Kjo do ishte themeli për fillimin e të gjitha aktiviteteve. Komunikimi rrugor në rajonet rurale, hapja e shtëpive për turistët edhe në fshatrat malor, definim të vendeve për kamping, si dhe ofertë më e madhe e përmbajtjeve të ndryshme avanturistike. Por, jo edhe kaq, në qoftë se këto gjëra do t'i kishim, duhet medoemos të punohet me edukim të popullatës lokale, duhet pajtueshmëri të standardeve me vendet tjera më të zhvilluara, identifikim të rajonit në



HISEN XHEMAILI

Format e shumta dhe të llojllojshme morfologjike - cirqet, lumenjtë, liqenet, morenat, luginat e akullnajave, grykat, kanionet, shpellat dhe peizazhet atraktive relievo... mund të shfrytëzohen për qëllime turistike. Aktualisht mungojnë kapacitetet e akomodimit në vendbanimet brenda Malit Sharr në fshatrat e Malësisë, nuk ka informacione të mjaftueshme, ndërsa agjencitë turistike nuk e kanë të përfshirë në ofertat turistike për akomodim



NEXHBEDIN HALITI

Mungesa e investimeve dhe sidomos e infrastrukturës mbajnë peng edhe mundësinë e zhvillimit turistik të kësaj zone me vlera të mëdha natyrore. Atraksionet e veçanta në bjeshkët e Sharrit janë sytë e Sharrit, apo janë 39 liqenet e Sharrit, ujëvara në Leshnicë, Skakallë, Bellovisht dhe në Vicë... Kanionet në Xhinibegj, Leshnicë e Epërme, Çaushicë dhe Vracë. Masivet gurorë në Pllat, Xhinibegj, Piribeg, Çelepinë dhe në Kubilicë dhe lumenjtë Shkumbini, Muzdaçja, Bistrica, lumi i Bogovinës dhe lumi i Vicës

nivel ndërkombëtar, si dhe promovim të saj më gjerë. Ajo që është me e rëndësishme është se duhet bërë një studim gjithëpërfshirës me kahje dhe plane detajore për çdo segment të zhvillimit të turizmit malor", deklaroi Metin Muaremi, kryetar i Organizatës CED, dhe përfaqësues i platformës "Miqte e Sharrit".

Në të kaluarën, sipas informacioneve, Ministria e Ekonomisë kishte caktuar një buxhet për të subvencionuar qytetarët për adaptim të shtëpive për akomodim, por nuk janë shfrytëzuar. Përndryshe, janë me mijëra banorë të Malësisë së Tetovës që kanë braktisur vatrat e tyre për një jetë më të mirë në vendet evropiane, duke lënë shtëpitë e tyre në vendlindje të pabanuara, dhe kjo do të ishte mundësi e mirë që të njëjtat të shndërrohen në bujtina, hotele, restorante për vizitorë të huaj.



Një ditë pas

Nga
Fatmir BESIMI



Nëse përcjellim disponimin e qytetarëve mund të presim se, nga ata që do të votojnë, shumica do të përkrahin referendumin i cili mban vulën euro-atlantike. Ky do të ishte edhe një vërtetim i faktit që shumica e qytetarëve për më shumë se dy dekada në vazhdimësi kanë treguar përkrahje jashtëzakonisht të lartë për anëtarësim të Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Gjithsesi, kjo përkrahje edhe duhet të shndërrohet në vota në ditën e referendimit, që njëherit është obligim qytetar edhe me i lartë sesa vota në zgjedhjet politike.

Nëse në zgjedhje përcaktohe mi për njërin ose tjetrin opSION politik për katër vitet e ardhshme, në këtë referendum kemi mundësinë e përcaktimit historik - në çfarë drejtimi do të shkojmë! A do të jemi në familjen e vendeve të zhvilluara, në NATO dhe BE apo do të mbetemi jashtë dhe pa alternative për siguri më të lartë, stabilitet dhe prosperitet në të ardhmen. Vota PËR, do të thotë investim për ardhmërinë evropiane, votë për jetë më cilësore. Ky do të jetë investim i këtij brezi!

Investim për administratë më efikase dhe profesionale, e cila do të jetë servis i qytetarëve që të mos presin në sportele dhe korridore. Administratë që është e vetëdijshme që paguhet nga taksa e qytetarëve.

Investim për mjedis më të pastër dhe vetëdije më të lartë për kujdesin ndaj natyrës, mjedise më të bukura urbane dhe rurale me infrastrukturë më të mirë dhe hapësira me gjelbërim, parqe dhe rrugica për biçikleta. Investim për bujqësi moderne, ushqim të shëndetshëm dhe vetëdije për mënyrë të shëndetshme të jetesës. Investim për shëndetësi më cilësor, mjek me paga të mira, profesionistë të shquar dhe në hap me trendet botërore. Klinika, spitale dhe ambulanca mirë të pajisura dhe me staf medicinal profesional dhe të sjellshëm që të i ndihmojnë ata që kanë nevojë.

Investim në arsim cilësor dhe modern, me arsimtarë me standard dinjitoz të cilët do të edukojnë breza të ri, kreativ dhe me integritet, të kalitur për të u përballur me sfidat e jetës dhe breza që do të jenë në trend me mundësitë që ofron zhvillimi teknologjik dhe globalizimi. Rini me energji ta çojnë vendin përpara duke lënë gjurmë në hartën e botës së sportit, kulturës,



shkencës, biznesit dhe politikës.

Investim për përkujdesje sociale për më të moshuarit, për fëmijët, personat me nevoja të posaçme dhe për të varfrit. Të gjithë kanë të drejtë të barabartë dhe meritojnë jetë më të mirë!

Investim për gjyqësor të pavarur dhe sundim të ligjit që të gjithë të jenë të barabartë para ligjit. Gjyqtar me integritet, të cilët me vendime të drejta do ta farkëtojnë korrupsionin në muze. Investim për të drejtat e njeriut dhe liritë individuale, lirinë e shprehjes dhe media të pavarura, të mbrojtur nga lajmet e rrejshme dhe nga keqpërdorimet kibernetike. Investim në demokraci, në qeverisje të mirë, të përgjegjshme, transparente dhe efikase, me rezultate në politikat dhe reformat për të realizuar programet me të cilat kanë fituar besimin e qytetarëve në zgjedhje. Investim në kohezionin shoqëror dhe marrëdhënie të mira ndër-etnike, vlera që kemi në traditën tonë të multikulturalizmit.

Investim në rritje më të lartë ekonomike, gjegjësisht rritje prej 5-7%, që do të përgjysojë rrugën e përafritimit me standardin evropian në 35 vjet krahasuar me 70 vjet të projektuara nga Banka Botërore sipas BPB për frymë nëse vazhdon dinamika e deritashme e rritjes ekonomike me 2-3% në nivel vjetor. Por, kjo nuk është vetëm një analizë, jo vetëm një teori, por diçka tani më

e provuar nga vendet të cilat pasi u bënë anëtare të NATO dhe BE në periudhën e pas-tranzicionit ekonomikisht janë rritur më shpejtë se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tanimë janë më afër standardit evropian.

Ky do jetë një investim për një strategji ambicioze për rritje ekonomike, e cila do të sigurojë rritje të shpejtë, inluzive dhe të qëndrueshme. Sipas diagnostikës së Bankës Botërore, ajo do të fokusohet në tre shtylla, dhe atë: përforsimi i sektorit privat, zhvillim i kapitalit njerëzor dhe siguri i qëndrueshmërisë. Dinamizimi dhe rritja e aftësisë konkurruese e sektorit privat do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të lidhjeve tregtare, integritetit në zinxhirin e vlerës së shtuar, biznes klimë pozitive, avancimit të kapaciteteve të firmave, përkrahja e start-up bizneseve, përmirësimi i qasjes në financë dhe zhvillim i formave të reja të financimit. Zhvillimi i kapitalit njerëzor më konkurrues dhe të përshtatshëm do të sigurohet nëpërmjet arsimit cilësor dhe trajnime për të fituar aftësi profesionale gjatë gjithë ciklit jetësor, si dhe përkujdesje shëndetësore cilësore preventive dhe primare. Qëndrueshmëria nëpërmjet qeverisjes efektive, menaxhim i matur fiskal dhe avancim të menaxhimit me mjedisin jetësor do të realizohet duke siguruar sundimin e ligjit, me institucione sh-

tetërore kompetente dhe të besueshme të cilat janë të përgjegjshme para qytetarëve, qëndrueshmëri fiskale dhe qasje integrale dhe konsistence për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Thënë ndryshe, integrimi në tregun evropian, lidhja infrastrukturore me rajonin dhe stabiliteti makroekonomik, në një anë, me rritjen e investimeve, kapitalit njerëzor dhe aftësia konkurruese, në anën tjetër, do të përshpejtojnë rritjen ekonomike. Kjo për ekonomi të vogël do të thotë përfitim i tregjeve të reja dhe me këtë edhe rritje të eksporteve si dhe bruto prodhimit të brendshëm që do të sjellë edhe standard më të lartë të jetesës.

Për të arritur këtë Maqedonia patjetër të importojë dije dhe të krijojë një brez të kuadrove të arsimuar dhe profesion, të rinj dhe kreativ, ambicioz dhe me shumë kontakte në botë, të cilët do të realizojnë ëndrrën për të cilën zotohem ne sot - Maqedonia në hartën botërore të vendeve të zhvilluara nëpërmjet anëtarësimin në NATO dhe BE.

Me politika dhe reforma konsistente, kjo rritje ekonomike do duhet të përkrahët nga një fond nacional për investime strategjike sipas shembullit të Planit investues të Junkerit (Komisioni Evropian), apo Plani i Marshallit, i cili në rastin tonë përveç mjeteve shtetërore, do të tërheq edhe

Këto ditë, e tërë vëmendja është përqendruar kah 30 shtatori, dita e referendimit. Me të drejtë. Kjo është dita D, dita e vendimit historik për të ardhmen tonë. Dita kur secili nga Ne ka mundësinë të japë qëndrimin e vet, të jetë pjesë e vendimit të madhështor dhe të jetë hartues i së ardhmes. Dhe një ditë pas do të thotë, PO, isha këtu!



fonde private dhe institucione ndërkombëtare për të financuar projekte strategjike infrastrukturore, novacione dhe zhvillim. Ndërsa me anëtarësimin në BE, do të fitojmë një partner të madh në realizimin e ambicieve tona për rritje më të shpejtë ekonomike. Kjo do jetë e mundshme nëpërmjet programeve dhe fondeve të ndryshme të BE-së, siç janë fondet strukturore, fondi i kohezionit, fondi social, programet për zhvillim rural dhe bujqësi dhe mjedis jetësor, programe për mobilitet të rinjve, fonde për arsim, fonde për përkrahje të kërkimeve, novacioneve dhe sipërmarrësive, si dhe shume programe tjera të cilat për nga madhësia dhe vlera janë të pakrahueshme me mundësitë që tani i kemi në dispozicion.

Me referendumin nuk përfundon rrugëtimi ynë drejtë nirvanës evropiane, por tani fillon. Nuk do të jetë proces i lehtë dhe thjeshtë, do të ketë ditë të ngarkuara dhe me shumë punë, por një gjë është e sigurt, kjo është rruga e vetme që na garanton të ardhme të ndritur!

Një ditë pas, referendumi do të jetë një investim për të sjellur Evropën në Maqedoni!

(Autori është profesor në Universitetin e Evropës Juglindore dhe ish-zëvendëskryeministër për Çështjet Evropiane)

Më 30 shtator ti vendos
për ardhmërinë tënde!

**DIL PËR
MAQEDONINË EVROPIANE!**



www.izleziza.mk

Gabimet me referendumin



Nga
Nazim RASHIDI

Shumica e qytetarëve në Maqedoni gjithmonë ka qenë pro NATO dhe BE. I tillë është sentimentu edhe sot, sipas disa sondazheve. Por sentimentu nuk është mbështetës ndaj klasës politike. Sidomos popullsia shqiptare ka një rezervë për gjithçka që ka ndodhur muajt e fundit, e cila lidhet kryesisht me zhgënjimet që i prodhon politika.

Partitë se pranojnë por frika e shprehur nën zë është se ky sentiment, mund të krijojë efektin e mosdaljes në votime si dënim ndaj klasës politike, e jo si kundërshtim ndaj integriteteve apo mosmbështetje të referendumi. Dhe si vërtetim të kësaj që po them, ndodhi Sopot. Për herë të dytë. Për herë të dytë ata që ishin të pafajshëm e dërgeshin burgjeve iu tha se shteti s'mund të bëjë asgjë ndaj jush. Normal vjen pyetja: E pse të dal në referendum? Të lëmë këtë shtet e këta politikanë ende në pushtet plot papërgjegjshmëri? Njoftimi se të pafajshmit mund të mos dëmshpërblehen, përforcon të gjitha ndjesitë se ky shtet smund të jetë i drejtë.

Qarkulluan në media deklaratat e ministres së njëjtë të drejtësisë Renata Deskoska se si kish thënë më herët se duhej dhe si thoshte tani se mund të mos bëhej dëmshpërblimi, ndërkohë që i gjithë opinioni ende dëgjon ekon e zërit irritues të Gordana Jankullovske, ish-ministres së Brendshme kur thoshte se sopotasit janë të pafajshëm.

Kjo s'bie era Evropë apo jo? Dhe me të tilla situata nuk bindet dot opinioni se klasa politike, establishmenti në përgjithsi po reflekton apo se ka ndryshuar në veprim.

Për ironi, po sot, kur po botohet ky tekst rreth 40 zyrtarë të qeverisë së Maqedonisë janë në Bruksel. Fillon sot "screening"-u, apo grafia e kapaciteteve të shtetit nga ana e Bashkimit Evropian. Me këtë hap fillohet hyrja në BE dhe i cili praktikisht është një vlerësim për të gjitha kapilaret e shtetit për të dhënë diagnozë se sa kohë i duhet Maqedonisë që të shërohet dhe të konsiderohet shtet sipas standardeve të BE-së.

I pari kapitull, apo fushë që hapet për një analizë të tillë, por njëkohësisht edhe mbyllet i fundit është ai 23. Kapitulli i drejtësisë dhe të drejtave fundamentale.

Partitë në vogëlsinë e tyre të gjitha harrojnë se janë reflektim i aspiratave të votuesve të tyre që me vite kanë qenë pro NATO e BE. Ishte NATO vetë që për Sopotasit tha se ishin të pafajshëm. Ishte NATO që solli lirinë në Kosovë. Është NATO që aktualisht jep praktikisht mesazhin se shqiptarët janë pjesë vlerave perëndimore. Ishte NATO dhe BE që përfundi konfliktin në Maqedoni...



B a z a ligjore e të gjithë vlerave evropiane, që nga të drejtat themelore të njeriut e deri tek specifikat më të detajuara të fushave të ndryshme të funksionimit të BE-së.

Pikërisht atë që duan njerëzit që është standarde evropiane. Por si do arrihen këto standarde pa qenë pjesë e BE-së kur shprehen rezerva dhe mund të mos votohet pro referendumi si rezultat i veprimeve të klasës politike, por që do të thoshte një STOP për këtë aspiratë.

Një institucion tjetër i rëndësishëm i BE-së është Gjykata Evropiane e Drejtësisë e cila konside-

rohet si Gjykata Kushtetuese e BE-së. Detyra e saj është të sigurojë zbatimin e ligjeve të BE-së në të gjitha vendet anëtare. Gjykata ka juridiksion ndaj vendeve anëtare dhe mund të sjellë vendime kundër tyre. Është kjo ajo shtysë dhe shpresë se pse gjërat do të duhet të bëhen më mirë nëse je vend anëtar i BE-së. Këto janë ato institucione e standarde që do të ndalojnë raste si Sopot. Por si mund të ndodh kjo nëse referendumi dështon?

Çdo zyrtar i lartë i BE-së që erdhi në Maqedoni apo dhe që iu drejtua Maqedonisë tha se shansi për të qenë pjesë e sistemit të kërkuar, klubit me rregulla të qarta, është suksesi i referendumi.

Por paralelisht me zhgënjimin që sjell klasa politike ndodh edhe procesi tjetër ku thirrjeve për integritet duke mos mbështetur marrëveshjen mes Athinës e Shkupit, nuk i bashkohet VMRO DPMNE më e madha e opozitës.

I dimë të gjithë procedurat, se në votime duhet të dalin gjysma e elektoratit dhe gjysma e tyre të votojë pro. Por çështja nuk është vetëm tek minimi i këtyre shifrave që synon një pjesë e eksponentëve të opozitës, çështja është edhe tek koncepti që sjell për shtetin referendumi.

Nga VMRO DPMNE, artikullohet qartë se pranimi i marrëveshjes në fakt sjell një humbje të ekskluzivitetit që kanë maqedonasit ndaj shtetit. Marrëveshja Athinë –

Shkup krijon një inkluzivitet që në emërimin e institucioneve të shtetit, duke hequr fjalën "maqedonase" dhe duke e shndërruar në "të Maqedonisë". Pra jo "Qeveria maqedonase" por "Qeveria e Maqedonisë së Veriut" terminologji aq e kërkuar nga shqiptarët, për të reflektuar inkluzivitetin e shtetit. Të kuptohemi, nuk bëhet fjalë për etninë, as në marrëveshje, por për emërimin e shtetit. Shtet që do të ishte i të gjithëve. Sërish si do të arrihet ky inkluzivitet, përfshirje e institucioneve, apo edhe emërimi i tyre më i drejtë, me të cilin do identifikohen të gjithë që janë në Maqedoni, nëse referendumi nuk kalon?

Zgjedhja për shqiptarët mund të duket e vështirë në kontekst të asaj, se meritat për këto integritet do ti marrë një klasë politike që mbase se meriton, por nga ana tjetër mbetet mundësia që kjo elitë të vazhdojë me papërgjegjshmërinë. Në një rast të tillë ç'të bëhet?

Pra cila është zgjedhja: Të dënohet klasa politike me mos votimin e referendumi duke e lejuar atë të vazhdojë të mbijetojë? Kontradiktore dhe aspak shpresëdhënëse është kjo.

Për fat të keq fushata për referendumin i ngjan fushatave zgjedhore. Me të drejtë njerëzit neveriten sepse ju kujton të gjithëve premtimet elektorale. Por në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me një gjë të tillë.

BDI tenton të jap mesazhin se është mbi proceset. Njerëzit lodhen nga qasje të tilla. Argumenti më banal por dhe i vërtetë që vjen nga njerëzit është "si do na çoni në Evropë kur mbytemi nga plehrat". Dhe seriozisht si ka mundësi që këta kryetar komunash një herë si pastruan rrugët, shkollat, lagjet. Por sërish kjo votë nuk është dhe nuk do duhet të jetë për ta.

Aleanca për Shqiptarët, shpreh zemërim, ende vërehet mllafi ndaj lojërave politike vendore dhe paqartësia ndaj zhvillimeve politike. Më shumë edhe një pozicion jo komod i saj mes të qenurit kundër qeverisë dhe sërish pro saj për shkak të procesit edhe pse në artikullim theksohen integritet edhe ndër shqiptarë edhe të shqiptarëve në Evropë. Por vota pro referendumi s'është as për ata.

Kurse këta të "Besave", që tashmë janë plot gojë Evropë, haruan se janë të vetmit, që si asnjë parti tjetër shqiptare deri më tani, para një procesi zgjedhor shkuan e u falën në Turqi, tek një lider anti Evropian sidomos ndaj vlerave bazë siç është lira e shprehjes dhe mendimit, kurse tani thonë se i besojnë Brukselit. Por vota për referendumin s'është as për ta.

Vota pro në referendum është për vetveten, njerëzit, të ardhmen dhe kauzën e shqiptarëve këto 30 vitet e fundit. Partitë në vogëlsinë e tyre të gjitha harrojnë se janë reflektim i aspiratave të votuesve të tyre që me vite kanë qenë pro NATO e BE.

Ishte NATO vetë që për Sopotasit tha se ishin të pafajshëm. Ishte NATO që solli lirinë në Kosovë. Është NATO që aktualisht jep praktikisht mesazhin se shqiptarët janë pjesë vlerave perëndimore. Ishte NATO dhe BE që përfundi konfliktin në Maqedoni. Është BE që sjell shpresë se presionet gjatë rrugës së anëtarësimit do të sjellin jetë më të mirë. Është BE që sjell shpresë për barazi e drejtësi. Vota pro referendumi është për këto arsye dhe për një tjetër: Për të dënuar gjithë klasën politike për krejt vonesat, paafësinë dhe papërgjegjshmërinë ndër vite! Është një vendim mes pro kauzës, dhe jo pro elitës politike, që do të duket se do të realizojë këtë kauzë. Prandaj bëni mirë dallimin se pse do votoni. Vota nuk i shkon partive kësaj here.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goe Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok 14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuim: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 26 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndhimëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirrollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ERDOGANI KËRKON PAJTIM ME GJERMANËT

Erdogani ka qenë shumë herë në Gjermani, por asnjëherë nuk ka qenë kaq e kontestueshme vizita e tij në Gjermani sa këtë herë. Me vizitën shtetërore Presidenti turk do të harrojë grindjet dhe tensionet



Vitin e kaluar Recep Tayyip Erdoğan e akuzoi Kancelaren Merkel për "metoda naziste". Ishte një pikë e ulët e marrëdhënieve gjermano-turke. Tani Presidenti dëshiron pak para vizitës së tij shtetërore në Gjermani "fundin e plotë" të tensioneve me Gjermaninë. Një shkak për kthesën është me siguri grindja me SHBA për shkak të një prifti protestant amerikan që mbahet i arrestuar në Turqi. Sankcionet e SHBA e kanë shtyrë Turqinë në një krizë të thellë monetare. Prandaj Turqia e sheh shpëtimin në përmirësimin e marrëdhënieve me Evropën dhe para së gjithash me Gjermaninë, si

partneren kryesore tregtare.

Kalimi nga ashpërsia maksimale në kurs pajtimi tregon para së gjithash një gjë: Presidenti është pragmatik. Edhe kjo e ka ndihmuar këtë politikan të jashtëzakonshëm që të qëndrojë kaq gjatë në pushtet. Që prej rreth 16 vjetësh Erdogani (64 vjeç) është ai që përcakton fatet e Turqisë. Kur në qershor 2015 partia e tij islamike-konservatore AKP humbi shumicën absolute në Parlament,

ai organizoi pas pak zgjedhje të reja. Menjëherë u rivendosën raportet e vjetra të pushtetit. Në zgjedhjet presidenciale në fund të qershorit Erdogani fitoi me rreth 53 për qind të votave - dhe kjo megjithëse opozita që përndryshe nuk qe dalluar, bëri një fushatë të mrekullueshme elektorale. Që atëherë Erdogani është në krye të sistemit presidencial të krijuar prej tij, edhe si kryetar shteti, ashtu edhe si kryetar partie.

REAGIME TË PËRMBAJTURA NGA GJERMANIA

Reagimet nga Gjermania për tonet e reja, të buta të Erdoganit, megjithatë janë të përmbajtura. Zyra Presidenciale në Berlin u bë e ditur të hënën se deri sa të zhvillohet besimi i ri, është "ende një rrugë e gjatë". Sepse sipas pikëpamjes së Perëndimit, Erdogani ka ndryshuar më mënyrë dramatike. Në vitin 2004 Erdogani në postin e kryeministrit të Turqisë e kurorëzuan

madje "Evropian të vitit". Kancelari i atëhershëm gjerman, Gerhard Schröder e lëvdoi Erdogani për "an-gazhimin për më shumë liri, një mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut dhe për më pak tutelë shtetërore". Nga pikëpamja e kritikëve të tij Erdogani është pozicionuar sot kundër gjithë këtyre vlerave.

140.000 VETË TË PUSHUAR NGA PUNA DHE QINDRA TË ARRESTUAR NË TURQI

Pas përpjekjes për puç në 2016 ai arrestoi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që zgjati dy vjet dhe që përfundoi vetëm në verën e këtij viti, dhjetëra mijëra vetë si gjoja armiq të shtetit dhe terroristë. Rreth 140.000 vetë u pushuan nga puna nga shërbimi për shtetin. Por masat goditën edhe gazetarët, veprimtarët e të drejtave të njeriut dhe intelektualët, të cilët qenë shprehur në mënyrë kritike ndaj shtetit. Edhe sot arrestimet dhe pushimet nga puna vazhdojnë. Pas zgjedhjeve të qershorit, me një numër të madh dekretesh - për të cilat atij tani nuk i duhet më aprovimi i parlamentit - ai e ka riorganizuar shtetin sipas vullnetit të tij duke i kaluar shumë kompetenca në zyrën e tij presidenciale. Numrin e ministrive ai e pakësoi. Politikanët e opozitës paralajmërojnë për rrezikun e "sundimit të një personi". (DW)



Trumpi pranon çfarëdo marrëveshje Kosovë-Serbi

Sipas shkrimit të mediave serbe, presidenti amerikan Donald Trump, gjatë bisedës së shkurtër me kryeministren serbe Ana Brnabiç, ka thënë se serbët janë popull i mirë. Në të vërtetë, Brnabiç e ka falënderuar presidentin amerikan për ndryshimin e qëndrimit të administratës së re të Uashingtonit ndaj Serbisë dhe mirëkuptimin për qëndrimin e Serbisë rreth çështjes së Kosovës, ndërsa ai në këtë, sipas mediave serbe, është përgjigjur se serbët janë popull i mirë. Brnabiç ka marrë pjesë në takim tradicional të cilin presidenti amerikan e mban në prag të debatit të përgjithshëm në selinë e OKB-s, ndërsa të enjten do t'u drejtohet vendeve anëtare. Siç shkruan gazeta serbe "Novosti", Amerika është e gatshme që çështjen e Kosovës ta 'rishikoj' dhe nëse Prishtina dhe Beogradi arrijnë marrëveshje, ata do ta pranojnë. Gazeta tjetër serbe "Blic", shkruan se Trump edhe personalisht ka konfirmuar ndryshimin e politikës amerikane rreth çështjes së Kosovës dhe relaksimin e raporteve ndaj Serbisë.

RAPORT I AMBASADORËVE EVROPIANË NË PRISHTINË

Ndryshimi i kufijve nuk ka gjasa të kalojë pa dhunë

Ndryshimi i kufijve të Kosovës nuk ka gjasa të kalojë pa dhunë. Kështu citohet të kenë vlerësuar disa ambasadorë evropianë në Prishtinë, në një raport konfidencial të hartuar për nevojat e Këshillit Evropian për Marrëdhënie të Jashtme (ECFR), një organizatë panevropiane me ndikim të madh, shkruan Koha Ditore. Raporti vlerëson se edhe Thaçi ka nisur ta humbasë përkrahjen e vëzhguesve të huaj në Kosovë, ndërsa kundërshtarë të idesë së tij për ndryshimin e kufijve dhe këmbimin e territoreve i përmend të jenë kryeministri Ramush Haradinaj, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Lëvizja Vetëvendosje.

"Të dyja palët në debat rreth idesë së 'korrigjimit të kufijve' janë të përcaktuara qartë në vend: Kryeministri Ramush Haradinaj, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, dhe partia opozitare Vetëvendosje e kundërshtojnë idenë, derisa presidenti Hashim Thaçi është përkrahësi i saj kryesor", thotë raporti.

Raporti 3-faqesh, një kopje të të



cilit e posedon "Koha Ditore", është hartuar nga Norbert Roettgen, kryesues aktual i Komisionit për Politikë të Jashtme në Parlamentin e Gjermanisë, Bundestag, dhe Robert Cooper, ish-mbikëqyrës i dialogut teknik mes Kosovës dhe Serbisë, dhe trajton çështjen e referendumit për emrin e ri të Maqedonisë, si dhe debatin në Kosovë

rreth ndryshimit të kufijve. "Ndryshimi i kufijve nuk ka gjasa të kalojë pa dhunë. Shenjat tashmë janë të qarta, si nga pala serbe ashtu edhe nga ajo kosovare. Duket se shkëmbimi, përveç një pjesë të ndërkombëtarëve, mbështetet vetëm nga dy presidentët - Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiç", thuhet në raport.

Klubi i basketbollit Shkupi edhe sezonin e ardhshëm do të jetë pjesë e Ligës së Parë basketbollistike pasi klubi nga Çairi mori pajtimin e klubeve tjera të Ligës që të jetë pjesë e elitës

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 26 shtator - Tani më gjithçka është zyrtare, ekipi i basketbollit Shkupi edhe sezonin e ardhshëm do të jetë pjesë e Ligës së Parë basketbollistike pasi klubi nga Çairi mori pajtimin e klubeve tjera të Ligës që të jetë pjesë e elitës. Skuadra nga Çairi nuk i respektoi dy afatet e dhëna nga ana e Federatës së Basketbollit që të paguan kotizimin, mirëpo në ndërkohë është gjetur sponsor stabil dhe dorëzoi kërkesë që të kthehet në Ligën e Parë. Të gjitha klubet elitare dhanë dritë të gjelbër për rikthim të Shkupit, po ashtu pritet që edhe Bordi Drejtues i Federatës së Basketbollit të pranohet qëndrimin e klubeve. "Ishte një dilemë e madhe pasi jo që kishim kusht vetëm kotizimin po kishim kushtet edhe pajtimin e të gjitha klubeve. Mirëpo ishte në favor tonin pasi kishim marrëdhënie të mira me të gjitha klubet e Ligës së Parë, dhe këto marrëdhënie do të vazhdojnë edhe në të ardhmen dhe kështu nuk kishim dyshim se do të na kundërshtojnë dhe të gjithë votuan në favorin tonë që Shkupi të qëndron të luaj në Ligën e Parë dhe kështu në Çair do të luhen prapë basketbolli i Ligës së Parë që është

BASKETBOLL

ZYRTARE: SHKUPI MBETET NË LIGËN E PARË



dëshirë e jonë dhe e gjithë adhuruesve të basketbollit", deklaroi Enver Miftari. Ekipi i Basketbollit Shkupi u ndihmua nga sponsori "Telekom" dhe nga Komuna e Çairit që të mbetet pjesë e basketbollit elitare, ndërsa gjatë ditëve pritet që në klub të ofrohet edhe një sponsor nga jashtë pikërisht nga Turqia mirëpo për këtë nga klubi i Basketbollit Shkupi do të dalin me informacion pasi të arrihet marrëveshja. "Qëndrimin tonë në elitë e ndih-

muan sponsori jonë "Telekom" me të cilët kemi një kontratë si dhe Komuna e Çairit, ku mund të them se nga këta të fundit kishim përkrahje të madhe. Mirëpo shpresa jonë ngjallet nga sponsori nga Turqia që pritet që gjatë ditëve në vijim të kemi takim dhe të vendosim për detaje", theksoi Miftari. KB Shkupi me qëndrimin në basketbollin elitare tani do të mundohet që të siguron lojtarë cilësorë pasi deri tani nuk kishin statusin e zgjedhur dhe kjo do

të jetë një hendikep për ekipin nga Çairi. "Do të mundohemi që të bëjmë një ekip cilësorë, pasi statusi jonë i pazgjedhur deri tani na ka bërë që të humbin shumë kohë dhe kjo do të jetë një hendikep për ne, mirëpo shpresoj se me afrimin e sponsorit do të përforcojmë klubin dhe do të jemi në nivel sa më të mirë", tha Enver Miftari. Nga ana tjetër Shoqata e Ligës së Parë përsëri për kryetar e zgjodhi Vidoja Sekulovski nga MZT.

Jeton Beqiri largohet nga Renova

Shkup, 26 shtator - Skuadra e Renovës ka mbetur pa trajnerin e saj Jeton Beqiri. Ky i fundit ka dhënë dorëheqje nga posti i trajnerit, duke lënë klubin në duart e ndihmësve të tij, që pritet të udhëheqin skuadrën gjatë ndeshjeve të ardhshme deri në afrimin e trajnerit të ri. Rezultatet e dobëta janë arsyeja kryesore e largimit të Jeton Beqirit nga posti i trajnerit te Renova, ishte pikërisht ndeshja e humbur si vendase përballë Bellasicës me rezultatin 2:0 që bëri që Beqiri të jep dorëheqje. Ekipi i Renovës në drejtim të Jeton Beqiri regjistroi vetëm një fitore, një barazim dhe 4 humbje në kampionat, po ashtu në drejtimin e Beqiri u eliminua edhe nga Kupa e Maqedonisë, pas asaj disfate të papritur nga Tikveshi. Nga kryesia e Renovës e kanë konfirmuar largimin e trajnerit Jeton Beqiri, ndërsa pritet që gjatë ditëve në vijim të gjejnë trajnerin e ri. (F.N)



Bardhi: Mezi pres ta shënojë golin e parë



Enis Bardhi me Levanetn se kanë nisur mirë sezonin e ri në La Liga. Në katër ndeshjet e fundit kanë vetëm një barazim dhe tre humbje. Megjithatë, Bardhi është optimist se punët do të nisen nga e mbara për të dhe skuadrën e tij. "Të jem i sigurtë mezi po e pres golin e parë për Levanten në këtë sezon. Ndjehem mirë në planin fizik, dëshiroj të ndihmojë të dalim nga kjo periudhë e krizës dhe shpresoj se së shpejti do ta shënoj

golin e parë shumë të dëshiruar. Dëshira është e madhe, mirëpo jo edhe opsion, para se gjithash dëshiroj që Levante të filloj të fitojë e dimë se kemi kualitet për dicka të tillë", tha Bardhi, i cili sezonin e kaluar shënoi nëntë gola. Në javën e fundit, Levante përjetoi humbje katastrofale në terren të vet nga Sevilla me rezultat 2-6. Në javën e ardhshme, ata luajnë me Valladolidin si mysafirë, kurse më pas e presin Alavesin.

Balaj, shënon në kupë për Ahkmat Grozny

Bekim Balaj është rikthyer te goli në Rusi me Ahkmat Grozny, teksa këtë mesditë ka gjetur rrjetën nga pika e bardhë e penaltisë. Sulmuesi kuqezi ka shënuar në minutat shtesë të takimit, që Ahkmat Grozny luajti në transfertë ndaj SKA Khabarovsk, në ndeshjen e kupës. Takimi nisi mirë për Ahkmat që gjeti rrjetën në minutën 26` me anë të Sadaev, ndërsa Kabaev do të barazonte për vendasit në minutën e 78`. Do të ishte Mitrihev që do të shënonte golin e avantazhit më pas për Ahkmat në minutën e 85`, teksa dy minuta më vonë janë sërish vendasit që barazojnë me anë të Dedečko në minutën e 87`, duke e çuar takimin në kohën shtesë. Kështu Bekim Balaj, i cili e nisi si titullar ndeshjen dhe e luajti deri në fund, në minutën e 110` ekzekuton në mënyrë të saktë një penalti të fituar nga Ahkmat Grozny, duke kaluar skuadrën e tij në avantazh. Mirëpo miqtë nuk arritën të ruanin avantazhin deri në fund, pasi vetëm një minutë para përfundimit të shtesës, në të 119`, Kvekveskiri barazon



shifrat në 3-3 për vendasit. Janë gjuajtjet e penaltive ato që përcaktojnë kalimin e skuadrës së Ahkmat për në turin tjetër të kupës, pasi futbollistët e Grozny ishin më të saktë nga gjuajtjet e penaltive, duke fituar 2-4. Sakaq edhe nga gjuajtjet e penaltive, ishte sërish Bekim Balaj së bashku me Bernard Berishën, futbollistin e

përfaqësueses së Kosovës, që gjuajtjen saktë duke i dhuruar kualifikimin Ahkmat. Golat e Bekim Balaj, edhe pse në një ndeshje kupe, janë lajm i mirë edhe për kombëtaren shqiptare, pasi këto gola mund të çlirojnë sulmuesin në aspektin psikologjik, në prag të rigrumbillimit të kuqezinjve për ndeshjet e tetorit.

MENDES DHE RAIOLA, SA FITOJNË 10 AGJENTËT MË TË FAMSHËM TË SPORTISTËVE

Revista amerikane Forbes ka publikuar listën e menaxherëve më të fuqishëm në mbarë botën në sporte të ndryshme. Në grupin e 10 më të pasurve ka disa risi, ku shihet rikthimi i Jorge Mendesit në vendin e dytë



afatit kalimtar me transferimin e Cristiano Ronaldos nga Real Madridi drejt Juventusit për 100 milionë euro. Menaxheri portugez ka kaluar shifrën e 100 milionë eurove përfitime nga komisionet dhe parakalohet vetëm nga menaxheri i famshëm i bejsbollit, Scott Boras. Mendez, në hapësirën e 12 muajve i ka rritur përfitimet

	Agente	Sport	Commissioni	Contratti	Agenzia
1	Scott Boras	Baseball	\$105.16 milionë	\$1.9 miliardi	Boras Corp
2	Jorge Mendes	Soccer	\$100.52 milionë	\$1 miliardo	Gestifute
3	Jonathan Barnett	Soccer	\$79.56 milionë	\$795.6 milionë	Stellar Group
4	Jeff Schwartz	Basketball	\$66.78 milionë	\$1.7 miliardi	Excel
5	Mino Raiola	Soccer	\$62.89 milionë	\$625.9 milionë	Mino Raiola S.P.
6	Casey Close	Baseball	\$62.17 milionë	\$1.2 miliardi	Excel
7	Sam & Seth Levinson	Baseball	\$49.47 milionë	\$994.9 milionë	ACES
8	Volker Struth	Soccer	\$46.44 milionë	\$464.4 milionë	SportsTotal
9	Pat Brisson	Hockey	\$45.35 milionë	\$1.1 miliardi	Creative
10	Todd France	Football	\$41.84 milionë	\$1.4 miliardi	Creative

nëpërmjet komisioneve me 30.5%, duke shkuar nga 77 në 100.5 milionë dollarë. Shuma nga kontratat e nënshkruara nga klientët e tij rritet nga 770 milionë dollarë në 2017-ën në mbi 1 miliard në 2018-ën.

Buzëqesh edhe menaxheri, Mino Raiola, që futet në "top 5", duke u ngjitur brenda një viti nga vendi i 10-të në të 5-tin. Menaxheri i Ibrahimovicit dhe Pogbas në 2017-ën përfitonte nga komisionet 43.5 milionë dollar, me shumën totale nga kontratat e nënshkruara që arrinte 435 milionë dollarë. Gjatë 2018-ës, përfitimet e tij nga komisionet arrijnë 62.89 milionë dollar, me një qarkullim prej 628.9 milionë dollarësh.

Sa u përket agjencie, Gestifute e Jorge Mendezit renditet e shtata, ndërsa kryeson Creative Artists Agency. Si agjent është edhe Jonathan Barnett, i cili renditet në vendin e tretë, por ai punon me disa sporte, si kriket, boks e futboll. Agjencia e Raiolas klasifikohet në vendin e nëntë.

Publicitet

Në bazë të nenit 126 paragrafi 7 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 dhe 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017) dhe vendimit të Kryetarit të Komunës së Strumicës nr. 09-6286/1 të datës 20.07.2018, Këshilli i shkollës së SHFK "Marshall Tito" – f. Murtino, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të shkollës

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

- të ketë arsim sipëror, të përmbushë kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog;
- të ketë 5 vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore;
- të ketë të dhënë provimin për drejtor;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kandidatët krahas lutjeve duhet të paraqesin edhe dokumentet në vijim:

- diplomë për arsim të mbaruar;
- vërtetim për përvojën e punës në institucion edukativo-arsimor;
- certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
- certifikatë të shtetësisë;
- program për punë për periudhë prej 4 (katër) vjet;
- Vërtetim se në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afatet në pajtim me Ligjin për arsim fillor. Dokumentet e nevojshëm të paraqesin deri te Këshilli i shkollës së SHFK Marshall Tito – Murtino, Komuna e Strumicës.

Kryetari i KD të SHFK "Marshall Tito" – f. Murtino
Vladimir Hristomanov

Në bazë të nenit 89-a, 91 dhe 92-a të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95; 24/96; 34/96; 35/97; 82/99; 29/02; 40/03; 42/03; 67/04; 55/05; 113/05; 35/06; 30/07; 49/07; 81/08; 92/08; 33/10; 116/10; 156/10; 18/11; 42/11; 51/11; 6/12; 100/12; 24/13; 41/14; 116/14; 135/14; 10/15; 98/15; 145/15; 30/16; 127/16; 67/17 dhe 64/18) dhe nenit 99 paragrafi 5 i Statutit të SHMSH "Iskra" – Shtip, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.09.2018 ka sjellë Vendim për publikim të:

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të Drejtorit të SHMSH "Iskra" – Shtip

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet në vijim:

- Për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme;
- Të ketë të mbaruar arsimin sipëror;
- Të ketë pesë vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- Provim të dhënë për drejtor të shkollës së mesme;
- Të ketë aftësi psikofizike dhe i aftë për punë.

Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të paraqesin dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me CV (biografi të shkurtë) dhe letër motivimi;
- Diplomë për arsim të mbaruar sipëror (original ose kopje të vërtetuar në Noter);
- Vërtetim për përvojë pune në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të Shkollës së mesme ose Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës së mesme dhe konviktin të nxënësve (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të mjekut;
- Certifikatë të shtetësisë së RM jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë se nuk është i dënuar;
- Program për zhvillim të shkollës për periudhë prej katër vjet;
- Vërtetime të tjera dhe dokumente për kualifikime të marra.

Neto pagesa fillestare është 36 000.00 denarë dhe orar të punës prej ora 7.00 deri në ora 15.00, gjegjësisht 40 orë në javë të orarit të punës.

Shpallja zgjatë tetë (8) ditë duke filluar të rrjedhë nga dita e ardhshme e ditës së publikimit në shtypin ditor. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen. Intervistën me kandidatët e paraqitur, të cilët i plotësojnë kushtet për drejtor, do ta realizojnë anëtarët e Këshillit të shkollës dhe përfaqësuesi i Byrosë për zhvillim të arsimit, për çka kandidatët do të informohen enkas. Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në afatin në pajtim me nenin 92-a të Ligjit për arsim të mesëm. Dokumentet e nevojshme të paraqesin deri te Këshilli i shkollës së SHMSH "Iskra" – Shtip deri në arkivin e shkollës ose përmes postës në adresën SHMSH "Iskra" – Shtip, rr. "Ribnik" nr. 14, 2000 Shtip, R. Maqedonisë, tel. për kontakt 032-308-860.

25.09.2018
Shtip

Kryetari i KD të
SHMSH "Iskra" – Shtip

/Pero Arsov /

Koha <http://www.koha.mk>

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goco Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdheshë, Shkup

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

LEO MESSI,

700 HERË ME BARCELONËN

Në fushën e Leganes, ylli argjentinasi luajti ndeshjen e tij të 700 me fanellën e Barçës, që nga debutimin e tij në ekipin e parë blaugrana. Ky udhëtim mbresëlënës dhe unik ka nisur në nëntor të vitit 2003, me një miqësore në fushën e Portos, kur ishte trajner Frank Rijkaard

Ka shifra që zakonisht kalojnë pa u vënë re, por që ilustrjnë shumë më tepër sesa të mbushin syrin. Jo shpesh ndodh, si në rastin e Leo Messit, që një numër tre shifror të mos mjaftojë për të matur dimensionin e tij si futbollist. Në fushën e Leganes, ylli argjentinasi luajti ndeshjen e tij të 700 me fanellën e Barçës, që nga debutimin e tij në ekipin e parë blaugrana. Ky udhëtim mbresëlënës dhe unik ka nisur në nëntor të vitit 2003, me një miqësore në fushën e Portos, kur ishte trajner Frank Rijkaard. Është e pamundur për të kuptuar historinë e re të Barcelonës pa Messin, figura referuese e futbollit të shekullit të 21-të, me më së shumti tituj në historinë e klubit katalanas (33). Në moshën 31-vjeçare, "10" e Barcelonës vijon të mahnisë me atë që bën në fushën e lojës. Ai, jo vetëm nuk e ka brak-



tisur frymëzimin si golashënues, por ka "inkorporuar" nuanca të reja në lojën e tij.

EVOLUCIONI I LOJËS SË TIJ

Messi e bëri të ditur këtë në intervistën që i dha "Radio Catalunya": "Gjatë viteve të fundit jam përmirësuar në pasimin e fundit, në asistet për shokët e ekipit". Dhe Leo Messi mbetet i pangopur në shënimin e golave dhe fitimin e trofeve, i vrullshëm dhe vertikal në lojën e tij. Nuk ndien lodhje, pavarësisht viteve që kalojnë. Ai do t'i luajë të gjitha ndeshjet. Në trurin e tij janë "sistemuar" 699 lojëra. Dhe ka vend për mjaft të tjera, që mbeten. Kundër Girona, të dielën e kaluar, Messi arriti një tjetër rekord, nga ato të dhënat e heshtu-

ra, por të rëndësishme: ai u bë lojtari i huaj me më shumë ndeshje në historinë e La Liga-s (423), duke mposhtur mikun e tij, Dani Alves. Një tjetër brazilian, Donato, ka arritur shifrën e 466 ndeshjeve, edhe pse kishte marrë shtetësinë spanjolle dhe për këtë arsye shihet ndryshe nga Alves dhe Messi.

14 VITË NË "FLUTURIM"

Më 16 tetor, Messi mbush 14 vite si lojtar i ekipit të parë të Barcelonës (debutoi kundër Espanyol), kohë në të cilën ka pasur kohë mundësinë për të thyer rekordet e pakapërcyeshme në dukje si golashënues. Argjentinasi arriti Di Stefano, Raul, Hugo Sánchez dhe Zarra, me 388 gola në elitën e futbollit spanjoll. Vetëm

12 "rrjeta" më pak për të arritur shifrën e 400 golave, një tjetër rekord, që meriton një analizë të kujdesshme dhe një "përmendore" nga futbollit spanjoll. Natyrisht, nuk ka kufizime në ambicjen e një futbollisti si Messi, i cili ka arritur të ruajë performancën e klasit botëror për gati 15 vite, një rrethanë praktikisht e paprecedentë në historinë e futbollit. "Messi është Maradona çdo ditë", tha Jorge Valdano për patriotin e tij. Kanë kaluar 5428 ditë që nga pagëzimi i tij si lojtar i ekipit të parë të Barçës dhe Leo nuk është lodhur së fituari. Rrugëtimi i tij mbërrin sonte në një "stacion" të veçantë, që është ndeshja e 700-të me Barcelonën, por të tjera rekorde presin të thyhen prej pesë herë fituesit të "Topit të Artë".



Mou rrezikon, zbulohen lojtarët që janë kundër portugezit

Jose Mourinho ka shkaktuar pakënaqësinë e shumë senatorëve të Manchester United me punën që ka bërë në këtë sezon. Një burim anonim i klubit ka bërë të ditur për "ESPN" se vendimi i tij për t'i hequr Pogba-së rolin e zëvendës-kapitenit nuk është pritur aspak mirë nga grupi. Trajneri e ka marrë këtë vendim të martën, një ditë pasi Pogba kritikoi stilin e lojës së Manchester United, duke kërkuar që ekipi të kishte një mentalitet më sulmues në ndeshjet që luan në shtëpi. Kampioni i botës nuk ka qenë pjesë e skuadrës në ndeshjen e Kupës së Ligës, me "Djajtë e Kuq" që janë eliminuar nga Derby i Frank Lampard, skuadër që luan në Championship. Situata brenda ekipit është përkeqësuar pas deklaratave që Mou ka bërë pas ndeshjes, duke kritikuar hapur lojtarët. Një tjetër burim anonim, afër menaxherit të Pogba, Mino Raiola, ka thënë për "ESPN": "Mourinho ka humbur aftësinë për të krijuar një lidhje të fortë me lojtarët". Pavarësisht nga pakënaqësitë futbollistëve, klubi ka vendosur të mbështesë portugezin, me zëvendës-presidentin Woodward që ka konfirmuar se ai nuk do të shkarkohet. Një burim tjetër anonim, afër një lojtari të ekipit të parë të United, ka thënë për "ESPN" se futbollisti beson se ka bërë hapa mbrapa dhe nuk është përmirësuar aspak nën drejtimin e Mourinhos. Për shkak qëndrimit të klubit, që ka vendosur të mbështesë trajnerin, disa lojtarë janë gati të largohen verën e ardhshme. Pavarësisht nga të gjitha këto, i njëjti burim anonim ka thënë se Pogba nuk ka marrë një vendim përfundimtar në lidhje me të ardhmen e tij dhe se lajmet për largimin e tij të sigurt nga United nuk janë aspak të vërteta.

Botërori i turpër, Katar 2022 goditet nga skandali i radhës

Katar 2022 është mbuluar nga një tjetër re e zezë. Pas "kandidaturave të sabotuara", ka ardhur raporti i "Amnesty International", sipas të cilit dhjetëra punëtorë të kantierëve të Kupës së Botës nuk paguhën prej muajsh. Organizata për të drejtat e njeriut ka shpjeguar se këta punëtorë, pjesa më e madhe e të cilëve janë qytetarë të Nepalit, Indisë dhe Filipineve, duhet të marrin nga 1.370 deri në 2.470 dollarë nga ana e kompanisë "Mercury MENA". Për disa kjo shifër është e barabartë me 10 muaj rrogë (shumë prej tyre jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë). Raporti i "Amnesty International" ka theksuar se këto rroga të prapambetura "kanë shkatërruar jetë" dhe ka ftuar qeverinë e Katarit të paguajë shumën e prem-



tuar. Raporti i "Amnesty International" është bazuar te intervistat e 78 punëtorëve të kompanisë (që kanë kontribuar në realizimin e shumë projekteve, mes të cilëve edhe stadiumin e Lusail, ku do të zhvillohet ndeshja hapëse), por ka

shtuar se mund të jenë qindra persona të përfshirë. Sikur të mos mjaftonte kjo, këta punëtorë janë të bllokuar në Katar, mijëra kilometra larg shtëpisë, pa para dhe nuk kanë arritur të largohen, sepse ligjet e vendit kërkojnë që

punëtorët të marrin një leje nga punëdhënësi i tyre para se ta bëjnë një gjë tjetër. Ndër të tjera, "Amnesty International" ka specifikuar se në 2017-ën, drejtori ekzekutiv i "Mercury Mena", ka thënë se kompania e tij "ka qenë viktimë e partnerëve tregtarë të paskrupullt, të cilët kanë krijuar shumë probleme në lidhje me pagesat dhe klientët". Ndërkohë, ministria e punës e Katarit ka thënë se abuzime të tilla ndaj punëtorëve "nuk janë të tolerueshme" dhe se ka "procedime gjyqësore" të paspecifikuara ndaj kompanisë "Mercury Mena". "Edhe pse Mercury Mena nuk operon më në Katar, hetimet do të vazhdojnë", lexohet në deklaratë. FIFA ka sqaruar menjëherë se kjo çështje "nuk ka asnjë lidhje me FIFA-n dhe Botërorin 2022".

FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



www.izleziza.mk

- Ndhimja totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.
- Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.
- 15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).
- 8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.
- 15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.
- 18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

www.izleziza.mk



DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo do të jetë një javë mjaft e ngjeshur e cila do ju lejojë që të arrini disa konkluzione të kënaqshme në vendin e punës. Sigurisht nuk do të mungojnë tensionet dhe ngacmimet me kolegët, por nëse do të tregoheni sa më diplomatë do të adoptoni një strategji mjaft efikase për të arritur objektivat tuaja.



DEMI 21. prill - 21. maj

Do të nisë një ditë mjaft statike, e cila sjell me vete edhe disa rreziqe të sferës ekonomike. Por një investim i mirë, mund të sjellë një sërë avantazhesh për projektet tuaja të së ardhmes. Kjo e mërkurë do ju gjejë disi të lodhur dhe ndoshta do të jeni në kërkim të stimujve të rinj emocionale.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Këshillohet që të jeni më të sinqertë sidomos në çështjet e ndjenjave. Nëse jeni në dilemë mes dy lidhjeve, mos merrni vendim pa u qartësuar mirë. Në vendin e punës, duhet të jeni më të kujdesshëm.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Po planifikoni aktivitetet e reja, të cilat do të rezultojnë mjaft interesante për aktualitetin tuaj profesional. Kursejini energjitë tuaja, për angazhime më të rëndësishme, ose në të kundërt fundi i ditës do ju gjejë të shkatërruar.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Parashikohet një ditë të cilën duhet ta kaloni bashke me gjithë ata që ju bëjnë të ndiheni rehat. Në dashuri duhet të jeni sa më kurajozë. Gjeneroni një person që të dijë të vlerësojë edhe anën më të ndjeshme të karakterit tuaj.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ky është një moment shumë i mirë për ti treguar partnerit/ës, edhe anën tuaj më emocionale. Kjo hapje do ju lejojë që të forconi raportin tuaj dhe të gjeni një intensitet të ri. Në vendin e punës duhet të jeni sa më karizmatik, por kujdes ndaj ndonjë shpenzimi të rrezikshëm.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kjo është një periudhë ideale për të forcuar pozitën tuaj në sferën profesionale. Këshillohet që të mos ndaleni përballë pengesave të ndryshme, me të cilat do të përballeni në rrugë, shkruan noa.al. Intuita e mirë do të sjellë rezultate të mëdha.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo e mërkurë parashikon konfirmime të rëndësishme në të gjitha fushat e rëndësishme të jetës. Një projekt i ri do të aprohet pa problem dhe një histori e re mund të jetë më se e frytshme. Duhet të jeni përgatitur për të bërë një ballafaqim në familje.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të arrini të merrni pjesë në një projekt i cili do të japë një shtysë të rëndësishme karrierës tuaj gjatë muajve të ardhshëm. Duhet të jeni të gatshëm të çoni përpara ide dhe nisma për të rigjetur stabilitetin tuaj. Në mbrëmje, do të jeni të fokusuar tek familja dhe ndjenjat tuaja.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo ditë do të jetë mjaft e qetë dhe relaksuese. Do të ndjeni nevojën për tu karikuar me energji dhe kjo ndoshta për shkak se gjatë javëve të fundit keni qenë shumë të stresuar. Mbrëmja parashikohet të jetë mjaft romantike.



UJORI 21. janar - 19. shkurt


Kjo e mërkurë do të jetë mjaft e rëndësishme për të rigjetur interesin në disa çështje të së kaluarës suaj, të cilat për një sërë arsyesh i keni lënë pas dore. Mundohuni të mos humbni kohë me diskutime të kota, lidhur me negociata që janë në vijim.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Përballja me familjen tuaj ose partnerin/en, nuk është asnjëherë e lehtë, sidomos nëse në qendër të diskutimit është një çështje burokratike ose ekonomike. Këshillohet që të jeni sa më diplomatë dhe të mos shfaqeni shumë agresivë.

Mensur Mamuti	NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO	TË BËRIT KËRKESË PËR TË RISHIKUAR NJË VENDIM TË DHËNË NGA GJYQI	NOVELISTE AMERIKANE VEPËR E FATMIR GJESTILËS	M	FOSHËNË (BISED.)
QYTETI I LINDJES DHE KLUBI I PARË I FUTBOLLISTIT NË FOTO					
MARKË GJERMANE AUTOMOBILASH					
UJDHESË NË SEJSHËLE (UJDHESA E SHQIPONJËS)					
KARRIGE					
ATLETI ETIOPIAN, FANTAJE PËRPUTHJE E RRQKJEVE TË VARGJEVE					
R					NGJYRA E LEKURËS
AUSTRIA		PËRFUNDIM NË SHAH LLOJ KËRPËDHE			
KOHA	PE I TRASHË PËR TË THURUR PERDE DIÇKA QË MBETET NË MENDJE ANË KUJTESË				
NJË GJUHË NË PAPIJA GUINE TË RE				NOMEN POLITIKANI RUMUN, ADRIAN	VËLLAU I FUTBOLLISTIT NË FOTO
FUTBOLLISTI NË FOTO					REGJISORI SHQIPTAR, DHIMITER
SEND QË VËNDOH. PËR TË MOS U PRISHUR NAMAZI					LËSHIME TË AEROPLANËVE NË TOKË
					KNOCK OUT
S					NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO
PIKTOR FRANCEZ					
HEBRE					SUPERMEN JOD
Ç					
TEMPERATURA		PJESA E SIPËRME E DHOMËS AR (FRËNGJ.)			AZOTI FRANKA
MOHIM			SUEDIA NORVEGJIA		VAJZA E BUKUR, QË BANONTE NË LUJERA E NË MALE (MIT. GREKE)
NOVELISTI AMERIKAN, HEMINGVEJ					SULFURI
					TITULL FISNIK ANGLEZ



NË KETË DATË

27 SHTATOR 1972

XHAKA, SUTRA, AUTOR, LUIS HUVES, ÇIFUT, LARJE, T, TAVANI, N, JO, S, NIMFA, ERNEST, ERL, ZGJIDHJET, M, BAZEL, OPELI, REMIR, ULËSE, SIRAK, RIMIM, A, MAT, TIRE, NAI, N, GRANIT

shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

6		5		2		7				3		2		7		1	
				8		2	4					8				4	
7										5							3
				3	9							6		1		4	7
8	4							3	1				5	6	2		
				8	6					9	2			7		5	
5	9								3	2							9
	7			4								5				3	
				1		9		8			6		1		9		8

Shumë i lehtë: 685324719, 913687245, 724195386, 156439827, 849752631, 237861594, 591278463, 378946152, 462513978. Mesatar: 439257618, 678391452, 512648973, 856913247, 743562891, 921874536, 287435169, 195786324, 364129785.

Kali që mësoi vogëlushen të flasë

Luftoi çdo ditë të jetës së saj për të folur por nuk mundi. Charlotte Roberts ka tentuar gjithmonë që të komunikojë, por për shkak të problemeve me zhvillimin nuk ka mundur. Por pas një takimi të pazakontë, gjithçka ndryshoi: si në një përrallë, prania e një kali të vogël pranë shtëpisë, një përqafim spontan dhe i papritur, kalërimet e gjata së bashku me të, bënë që vajza të dalë përgjithmonë nga izolimi i saj, duke nisur të komunikojë. Sipas asaj që raporton "Daily Mail", më parë vajza ishte e mbyllur në vetvete dhe kur tentonte që të fliste, ishte e vështirë të kuptohej se çfarë donte të thoshte. Viktimë e bulizmit në shkollën speciale, Charlie falë kalit poni nisi që të hapte qejnë në takimin e parë. "Luafra kalit dhe e përqafoi, tregon nëna e



vogëlushes-, dhe duke u ndierë e sigurt ajo tha fjalën e parë 'kali'. Kujtoj fjalën e parë kur vajza ime i tha të atit: 'Hajde të

ikim". Tashmë komunikimi nuk është më një problem për vajzën, e cila nuk ndahet asnjë moment prej tij.

A duhen asgjësuar mushkonjat?



Gjendet mënyra për zhdukjen e mushkonjave. Është inxhinieria gjenetike që vret femrat riprodhuese dhe kjo gjë është verifikuar tashmë në një kafaz të laboratorëve të universitetit Imperial College të Londrës. Kërkuesit kanë arritur të injektojnë një gen tek mushkonjat femra që është në gjendje të bllokojë fertilitetin me një metodë që rezulton 99% e suksesshme.

Kolapsimi i popullatës së insekteve bezdisës në laborator ka ndodhur brenda 7-11 gjeneratave në mënyrë të pakthyeshme. Kjo është hera e parë që arrihet një gjë e tillë dhe rezultati është publikuar në revistën shkencore Nature Biotechnology. Teknika e përdorur është emërtuar Gene Drive dhe konsiston në manipulimin e transmetimit të njëjtit gen ndër dy prindërit nga një brez në tjetrin. Deri më sot, të gjitha teknikat e tjera gjenetike të përdorura për zhdukjen e mushkonjave kishin dështuar, pasi këto insekte arrinin gjithnjë të krijonin rezistencë.

Tani kërkuesit do të vijnë punën për fazat e tjera të eksperimentimit, por edhe diskutimet etike nëse insekti duhet zhdukur nga zinxhiri i jetës. Aktualisht shifrat e fundit mbi dëmet e mushkonjave flasin për 216 mln të infektuar në vitin 2016 nga malarja, ndër të cilët 445 mijë me pasojë vdekjen.

Radiografia është shokuese, por pacienti është gjallë

Një i ri është detyruar që të mbajë të ngulur thikën në fytyrë për gati katër ditë pasi u sulmua. Arma e ftohtë është 10 centimetra e gjatë. Sipas asaj që raportohet pacienti, një 25-vjeçar nga Afrika e Jugut, pësoi "një dëmtim të stomakut gjatë grindjeve me mikun e tij të dehur".

Ai u dërgua fillimisht në një klinikë në Germiston, në lindje të Johannesburgut, përpara se të transportohej në një klinikë më të specializuar. Mjekët thanë se pacienti nuk u ankua shumë tek stafit mjekësor por thoshte se kishte vetëm një dhimbje koke dhe se e pengonte atë për të lëvizur syrin e majtë. Për shkak të madhësisë së plagës, oftalmologët spitalor kanë kërkuar ndihmën e specialistëve në otolaringologji, kirurgët maxilofacialë dhe neurokirurgët. Operacioni u krye me sukses dhe se mjekët ishin arritën që të hiqnin thikën. 25-vjeçari cili



më vonë pranoi se ndihej me fat që ishte gjallë, doli dy ditë pas operacionit dhe iu kërkuar të kthehej një muaj më vonë për kontrollet e zakonshme.

Kushëriri i mbretëreshës martohet me një mashkull



Lordi Ivar Mountbatten, i divorcuar dhe baba i tre vajzave, martohet me një mashkull. Kushëriri i Mbretëreshës Elizabeth është i pari në familjen mbretërore që ndërmerr një hap të tillë. 24 orë më parë, Lordi Ivar dhe i dashuri i tij James Coyle shkëmbyen unazat me njëri-tjetrin në prani të 60 familjarëve të tyre, përf-



shirë tre vajzat dhe ish-bashkëshorten e tij, transmeton KOHA shkrimin e mediave britanike. Për habi të të gjithëve, ish-bashkëshortja ishte e lumtur për vendimin, madje pozoi në një foto mes tyre. Kjo dasmë është e para e këtij lloji dhe më e veçanta në historinë e familjes mbretërore britanike.

1779 - John Adams negocion kushet e paqes nga Lufta revolucionare me Britaninë

1821 - Perandoria mexikane shpallë pavarësinë.

1919 - Komiteti Kombëtar Demokratik voton për të lejuar anëtarësimin e femrave.

1922 - Jep dorëheqje Mbreti Konstantin I i Greqisë.

1923 - Trupat Italiane largohen nga Korfuzi.

1928 - Shtetet e Bashkuara të Amerikës njohin Republikën e Kinës.

1936 - Trupat e Frankos pushtojnë Toledon.

1938 - Lidhja e Kombeve shpallë Japoninë agresore kundër Kinës.



PËRSE NA DALIN THINJAT

Sistemi i rritjes së flokëve është mjaft kompleks. Shkencëtarët vazhdojnë ta studiojnë procesin e rritjes së flokëve të njeriut, gjithashtu edhe strukturën e pigmentit. Në rritjen normale të flokëve, gjëndra prodhon flokë me një ritëm prej rreth një centimetër në muaj për disa vite. Kur qelizat që prodhojnë pigmentet e flokëve dëmtohen, atëherë flokët fillojnë ta marrin ngjyrë gri ose të bardha. Në moshën e pjekurisë, te disa persona flokët ndalojnë së rrituri dhe sistemi i rritjes së flokut hyn në një periudhë pushimi. Gjatë këtij procesi, melanocitet fillojnë të vdesin. Kur melanocitet janë të dëmtuara ose mungojnë, atëherë flokët që rriten ju mungon ngjyra dhe mund të duken gri ose të bardha.

RRËFIMI TE PRIFTI

Hyn njëri në kishë për tu rrëfyer.

Prifti e pyet:

- Çfarë mëkati keni bërë biri im?

- At, jam shume grykës.

- Grykësia është mëkat i madh. Për të të falur duhet ti japësh 50 euro të parit që do hasësh në rrugë.

- 50 euro, një të panjohuri?

- Biri im, nëse do të hysh në rrugën e drejtë duhet ta fillosh me këtë akt.

Del në rrugë, shikon rreth e rrotull asnjë njeri. Ecën pak, kur në një cep shikon një femër, në maje të takave, me mini, i afrohet - i zgjat 50 euro, dhe i thotë: - Urdhëro, merreni ju lutem!

- Jo, është pak, duhet të paktën 100.

- Po pse 100? Prifti më tha 50.

- Epo, prifti është klient i rregullt.

Në shtratin e vdekjes, arritjet dhe sukseset e tua nuk do të kenë aq vlerë sa kujtimet e vyera.

(thënie kineze)

KALENDARI 27 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA